



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FINANCE

RAPORTI VJETOR ANNUAL REPORT



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE
GENERAL DIRECTORATE FOR THE PREVENTION OF MONEY LAUNDERING

RAPORTI I PESTË VJETOR
FIFTH ANNUAL REPORT

2009



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FINANCE

RAPORTI VJETOR ANNUAL REPORT



**Adresa/Address: DPPP / GDPML
Rruga "Dora D'Istria" Nr.2, Tiranë, ALBANIA
Tel./Fax: +355 4 224 4 6 02
Internet: <http://www.fint.gov.al>
E-mail: public.relations@fint.gov.al**

2009

Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm

The Message from the General Director

Viti 2009 shënon konsolidimin e mëtejshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), në rolin e Njësisë së Inteligjencës Financiare Shqiptare, gjë që pasqyrohet më së miri edhe në shifrat e rezultatet e paraqitura në këtë raport vjetor.

Reforma legjislative e nisur prej disa vitesh, e cila arriti kulmin me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë në Maj 2008, të Ligjit Nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave e financimit të terrorizmit", vazhdoi gjatë vitit 2009 me miratimin nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Financave i gjashtë akteve nënligjore, duke përcaktuar qartë mënyrat dhe procedurat e raportimit nga subjektet, institucionet dhe autoritetet mbikqyrëse.

Në vitin 2009, u punua intensivisht dhe përfundoi hartimi i Dokumentit Strategjik Kombëtar "Për hetimin e krimit financiar", në kuadër të njërit prej komponentëve të Projektit të Binjakëzimit me kolegët gjermanë të Zyrës Kriminale Federale Gjermane (BKA), ku DPPPP ishte institucioni drejtues për palën shqiptare. Ky Dokument u miratua nga Këshilli i Ministrave në Tetor 2009, pas një procesi të gjatë konsultimi me aktorë dhe faktorë kombëtarë e ndërkombëtarë.

Rritja e vazhdueshme e raportimeve të informacionit dhe e të dhënave nga subjektet, thellimi dhe zgjerimi i analizës financiare të rasteve të dyshimta, kanë bërë të mundur që të shtohen rastet e referuara në prokurori dhe në organet e zbatimit të ligjit, në një nivel të pakrahasueshëm me vitet e mëparshme. Kjo është mundur nëpërmjet një administrimi dhe menaxhimi efektiv të burimeve njerëzore, logjistike e financiare, nga implementimi i legjislacionit të PPP/FT, si dhe nga futja në shkallë të gjerë e teknologjisë së informacionit.

Duke vlerësuar maksimalisht përpjekjet dhe punën e kolegëve të DPPPP-së, të cilët me angazhimin dhe predispozicionin e tyre kanë



Year 2009, was marked by further consolidation in the General Directorate for the Prevention of Money Laundering (GDPML), in its role of the Albanian Financial Intelligence Unit, that is best reflected in the numbers and results presented in this annual report.

The legislative reform initiated over the years, that culminated with the approval by the Albanian Parliament in May 2008, of the Law No.9917 "For the prevention of money laundering and financing of terrorism", continued during 2009 with the approval by the Council of Ministers of six bylaws, defining thus clearly the methods and procedures for reporting by

obliged entities, institutions and supervisory authorities.

In the framework of one of the components of the Twinning Project with German colleagues of the Federal Criminal Office (BKA), where GDPML was the leading Albanian institution, tasks were carried out persistently and they were concluded with the formulation of a National Strategic Document "On the investigation of financial crime". This document was approved by the Council of Ministers in October 2009, after a long procedure of deliberations with national and international stakeholders.

The continuous increase of information and data reported by the obliged entities, the deepening and expansion of financial analysis for the suspicious cases, have made it possible to increase the number of cases referred to prosecution and law enforcement agencies, at a level that is incomparable with previous years. This was enabled through a better management of the human, logistical and financial resources, implementation of the AML/FT legislation as well as the widespread utilization of information technology.

By appreciating the utmost efforts and the performance of the GDPML colleagues, that through their commitment and readiness have been the

qenë faktori përcaktues që ka mundësuar rritjen e ndjeshme të rezultateve të punës së Njesisë së Inteligjencës Financiare Shqiptare, njëherësh i falënderoj dhe përgëzoj.

Arritjet e vitit 2009 përbëjnë një bazë të fuqishme për vazhdimin e zbatimit me përpikmëri të legjislacionit kombëtar, rekomandimeve ndërkombëtare, si dhe politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të përcaktuara nga Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

Gjatë vitit 2010, DPPP do të vazhdojë të punojë ngushtësisht me institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare, të konsolidojë kapacitetet profesionale dhe teknike të personelit, të zbatojë objektivat e rëndësishme strategjike në fushën e hetimit të krimit financiar në përgjithësi dhe pastrimit të parave e financimit të terrorizmit në veçanti, të përgatitet seriozisht për vlerësimin që do t'i bëjnë ekspertët ndërkombëtarë të Komitetit MONEYVAL, kuadrit legjislativ dhe zbatues në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri, të intensifikojë përpjekjet për mbledhjen, analizimin dhe hetimin financiar të rasteve të dyshimta, të koordinojë përpjekjet ndërinstitucionale për zbatimin e Dokumentit Strategjik Kombëtar "Për hetimin e krimit financiar" dhe planit të tij të veprimit.

Unë shpreh bindjen se rezultatet konkrete të punës së DPPP-së do të kenë ndikim pozitiv në forcimin e mëtejshëm të zbatimit të ligjit dhe të rendit demokratik në vend, në forcimin e vazhdueshëm të integritetit të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë, si dhe do të kenë mbështetjen dhe angazhimin serioz të të gjitha institucioneve relevante si, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, institucionet partnere në nivel kombëtar, rajonal dhe më gjerë.

determining factor that has contributed towards the significant increase of the performance results of the Albanian Financial Intelligence Unit, I would like to at the same time, thank and congratulate them.

The achievements of 2009 constitute a solid ground for the continuation of the proper implementation of the national legislation, international recommendations and the general state policy in the prevention and fight against money laundering and terrorism financing, outlined by the Committee for the Coordination of the Fight Against Money Laundering.

During 2010, GDPML will continue to work closely with the national and international partner institutions to consolidate the professional and technical capabilities of the staff, implement important strategic objectives in the domain of investigation of financial crime in general and particularly money laundering/financing of terrorism, to prepare seriously for the evaluation of the Albanian legislative and implementing regime in the domain of prevention of money laundering by the international experts of the MONEYVAL Committee, intensify the efforts for the collection, analyzing as well as the administrative and financial investigation of the suspicious cases, to coordinate the inter-institutional endeavors for the implementation of the National Strategic Document "On the investigation of financial crime" and its action plan.

I express my conviction that GDPML's concrete performance results will have a positive effect in further strengthening the implementation of the law and the democratic order in the country, continuously reinforce the integrity of the financial system in the Republic of Albania, and will be associated with the serious support and commitment of all the relevant institutions such as the State Police, General Prosecutor's Office, partner institutions at the national or international level and beyond.

Arben DOÇI



Drejtör i Përgjithshëm / General Director

PËRMBAJTJA

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	3
Shkurtime	7
Datat kryesore	9
Hyrje	11
ZHVILLIMET KRYESORE DHE ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE TË PASTRIMIT TË PARAVE	13
REFORMA LEGJISLATIVE	14
RAPORTIME NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE	15
PUNA ME PROJEKTET	18
MENAXHIMI I BURIMEVE DHE PERFORMANCËS	21
NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE	24
INSPEKTIMET	26
MASAT ADMINISTRATIVE	28
MBLEDHJA, ANALIZIMI DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR	30
RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË VEPRIMTARIVE TË DYSHIMTA NGA SUBJEKTET RAPORTUESE	31
Deklarimet e valutës në pikat e kalimit të kufirit	33
RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË VLERAVE NGA BANKAT SI SUBJEKTE KRYESORE RAPORTUESE	34
Raportimi i transaksioneve të vlerave nga noterët dhe analizimi i tyre	35
Raportimi i transaksioneve të vlerave nga subjektet e tjera të ligjit	37
ANALIZIMI FINANCIAR DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	38
REFERIMI I RASTEVE TË DYSHIMTA NË ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT	40
RASTET E REFERUARA NË PROKURORI	44
MASAT E PËRKOHSHME	44
RASTE TË DËRGUARA NË POLICINË E SHTETIT PËR INVESTIGIM TË MËTEJSHËM	46
KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI	47
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL	48
BASHKËPUNIMI ME PARTNERË DHE INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE	52
BASHKËPUNIMI ME NJËSITË HOMOLOGE TË RAJONIT	54
BASHKËPUNIMI ME GRUPIN EGMONT DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT NËPËRMJET RRJETIT ESW	55
KOMITETI MONEYVAL	56
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2010	58

CONTENTS

THE MESSAGE FROM THE GENERAL DIRECTOR	3
Acronyms	8
Important milestones	9
Introduction	11
MAIN DEVELOPMENTS AND THE IMPLEMENTATION OF MEASURES AGAINST MONEY LAUNDERING	13
LEGISLATIVE REFORM	14
REPORTS IN THE FRAMEWORK OF THE FIGHT AGAINST MONEY LAUNDERING	15
PROJECTS' IMPLEMENTATION	18
MANAGEMENT OF RESOURCES AND PERFORMANCE	21
AWARENESS ENHANCING OF THE OBLIGED ENTITIES	24
INSPECTIONS	26
ADMINISTRATIVE SANCTIONS	28
COLLECTION, ANALYSING AND DISSEMINATION OF FINANCIAL INFORMATION	30
REPORTING OF SUSPICIOUS TRANSACTION ACTIVITIES BY THE OBLIGED ENTITIES	31
Cross border cash declarations	33
REPORTING OF VALUE TRANSACTION REPORTS FROM BANKS AS THE MAIN OBLIGED ENTITIES	34
Reports of value transactions from the notaries and their analysis	35
The reporting of value transactions from other obliged law entities	37
FINANCIAL ANALYSIS AND INFORMATION TECHNOLOGY	38
REFERRALS OF SUSPICIOUS CASES TO LAW ENFORCEMENT AGENCIES	40
CASES REFERRED TO THE PROSECUTION	44
TEMPORARY MEASURES	44
CASES REFERRED TO ALBANIAN STATE POLICE FOR FURTHER INVESTIGATION	46
COORDINATION AND COOPERATION	47
INTER-INSTITUTIONAL COOPERATION	48
COOPERATION WITH INTERNATIONAL PARTNERS AND INSTITUTIONS	52
COOPERATION WITH REGIONAL PARTNER INSTITUTIONS	54
COOPERATION WITH EGMONT GROUP AND THE EXCHANGE OF INFORMATION THROUGH ESW NETWORK	55
MONEYVAL COMMITTEE	56
OBJECTIVES FOR 2010	58

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.
AMF	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.
ALUIZNI	Agjencia për Legalizimin dhe Urbanizimin e Zonave dhe Ndërtimeve Informale.
BE	Bashkimi Europian.
BSH	Banka e Shqipërisë.
BKA	Zyra Kriminale Federale Gjermane.
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
DBLKPP	Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
DSIK	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë.
EKA	Ekspert Kontabël i Autorizuar.
ESW	Egmont Secure Web.
FATF	Grupi i Veprimit Financiar.
FIU	Njësi e Inteligjencës Financiare.
ILDKP	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
ILECU	Njësitë Ndërkombëtare të Koordinimit të Agjencive të Zbatimit të Ligjit.
KE	Këshilli i Europës.
KBLKPP	Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.
JVI	Instituti i Bashkuar i Vjenës.
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave.
NjPH	Njësia e Përbashkët e Hetimit të Krimit Ekonomiko-Financiar dhe Korrupsionit.
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse.
OPDAT	Zyra e Projektit për Zhvillim dhe Trajnime e Departamentit të Drejtësisë e SHBA-së.
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Sigurinë në Europë.
PAMECA	Misioni i Asistencës Policore i Bashkimit Europian në Shqipëri.
PPP/FT	Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
PP	Prokuroria e Përgjithshme.
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht.
RAD	Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
RTV	Raporti i Transaksionit të Vlerave
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror.
TI	Teknologjia e Informacionit.
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara në Luftën Kundër Drogës dhe Krimit.
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
ZKV	Zyrë Këmbimi Valutor.
ZQRPP	Zyra Qendrore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

ACRONYMS

AASCA	Agency for the Administration of Seized and Confiscated Assets.
FSA	Financial Supervisory Authority.
ALUIAC	Agency for the Legalization and Urbanization of Informal Areas and Construction.
EU	European Union.
BoA	Bank of Albania.
BKA	German Federal Criminal Office- Bundes Kriminal Amt.
GDPML	General Directorate for the Prevention of Money Laundering .
DCFAML	Directorate for the Coordination of the Fight Against Money Laundering.
GDT	General Directorate of Taxation.
GDC	General Directorate of Customs.
ASP	Albanian State Police.
DSCI	Directorate for the Security of the Classified Information.
EGMONT	Network of Financial Intelligence Units in the World.
CPA	Certified Public Accountants.
ESW	Egmont Secure Web.
FATF	Financial Action Task Force.
FIU	Financial Intelligence Unit.
HIDAA	High Inspectorate for the Declaration and Audit of Assets.
ICPA	Institute of Certified Public Accountants.
ILECU	International Law Enforcement Coordination Units.
CE	Council of Europe.
CCFAML	Committee for the Coordination of the Fight Against Money Laundering.
JVI	Joint Vienna Institute.
MONEYVAL	Committee of Experts for the Evaluation of Measures Against Money Laundering.
JIU	Joint Investigation Unit for Investigation of Financial Crime and Corruption.
NPO	Non Profit Organizations.
OPDAT	Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training (US Justice Dept).
OSCE	Organization for Security and Cooperation in Europe.
PAMECA	Police Assistance Mission of the European of the European Community to Albania.
AML/FT	Anti Money Laundering / Financing of Terrorism.
PO	Prosecutor's Office.
PEP	Politically Exposed Persons.
SAR	Suspicious Activity Report.
VTR	Value Transactions Report.
SIS	State Information Service.
IT	Information Technology.
UNODC	United Nations Office on Drugs and Crime.
CMD	Council of Ministers Decision.
EO	Exchange Offices.
CORIP	Central Office for the Registration of Immovable Property

DATAT KRYESORE

- Në Maj të vitit 2000, Parlamenti Shqiptar, pas kërkesave të ripërsëritura të Këshillit të Europës dhe të Komitetit MONEYVAL, miraton Ligjin nr. 8610 datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave".
- Në Gusht të vitit 2001, krijohet Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave.
- Në Qershor të vitit 2003, Parlamenti Shqiptar, në zbatim të kërkesave të raportit të vlerësimit të dytë të Shqipërisë, nga Komiteti MONEYVAL, bën disa ndryshime të rëndësishme të ligjit për "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave", nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 9084 datë 19.06.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave".
- Në Korrik të vitit 2003, Njësia e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë bëhet anëtare me të drejta të plota në grupin EGMONT, gjatë sesionit plenar të mbajtur në Australi.
- Në Korrik të vitit 2004, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin nr. 9258 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".
- Në Gusht të vitit 2005, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave ngrihet në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave.
- Në Mars të vitit 2006 u publikua raporti i parë vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- Në Gusht të vitit 2006, KBLKPP- ja miraton Programin Kombëtar të Kontrollit të Lëvizjes së Parasë në dorë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Në Nëntor të vitit 2006 miratohen Ligjet nr. 9641, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për Parandalimin e Terrorizmit" dhe nr. 9646, datë 27.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e produkteve të krimit dhe të financimit të terrorizmit".
- Në Janar të vitit 2008, me Urdhër të Kryeministrit të Shqipërisë,

IMPORTANT MILESTONES

- May 2000, the Albanian Parliament, after repeated requests from the MONEYVAL Committee of CE approved the Law no. 8610, May 17,2000 "On the prevention of money laundering";
- August 2001, the Directorate for the Coordination of the Fight Against Money Laundering within the Ministry of Finance is created;
- June 2003, the Albanian Parliament, based on the demands of the second round of evaluation from the MONEYVAL Committee, made some important amendments to the law "On the prevention of money laundering" by approving the law no. 9084, June 19, 2003 "On some additions and amendments in the Law no. 8610, May 17,2000 "On the prevention of money laundering"".
- July 2003, the Albanian Financial Intelligence Unit became a member with full rights of EGMONT group, during the plenary session held in Australia.
- July 2004, the Albanian Parliament approved the Law no.9258 "On measures against the financing of terrorism";
- August 2005, the Directorate for the Coordination of the Fight Against Money Laundering (DCFAML) was promoted to a General Directorate within the Ministry of Finance;
- March 2006, the first annual report of General Directorate for the Prevention of Money Laundering is published;
- August 2006, CCFAML approves the National Program for the Control of Cash in the Republic of Albania;
- November 2006, approval of Law no. 9641, of 20.11.2006, "On the ratification of European Council Convention "For the prevention of terrorism" and Law no. 9646, of 27.11.2006 "On the ratification of European Council Convention "On the search, seizure and confiscation of proceeds of crime and terrorism financing";
- January 2008, GDPML undergoes a reorganization process based on the order of the Prime Minister. An IT section is established for the first time;

miratohet struktura e re e DPPPP-së, në të cilën krijohet për herë të parë Sektori i Teknologjisë së Informacionit.

- Në Maj të vitit 2008, Parlamenti Shqiptar miraton Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i cili përmbush rekomandimet e Komitetit MONEYVAL, pranë Këshillit të Europës të bëra në raport-vlerësimin e III-të reciprok MONEYVAL-SHQIPERI, si dhe ato ndërkombëtare të FATF- së.
- Në Shtator të vitit 2008 hyn në fuqi Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".
- Në Shtator të vitit 2009, në seancën e 30-të plenare të komitetit MONEYVAL, miratohet me unanimitet raporti dy-vjeçar i progresit të Shqipërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Në Shtator të vitit 2009, përfundon projekti i binjakëzimit, "Lufta kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar", në bashkëpunim me Zyrën Kriminale Federale Gjermane.
- Në Tetor të vitit 2009, me Vendimin nr. 1077, datë 27.20.2009, të Këshillit të Ministrave, miratohet Dokumenti Strategjik Kombëtar "Për hetimin e krimit financiar", në hartimin e të cilit DPPPP kishte rolin drejtues.
- Në Nëntor të vitit 2009, DPPPP prezanton para Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare punën dy-vjeçare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

- May 2008, the Albanian Parliament approves the Law no. 9917, May 19, 2008 "On the prevention of money laundering and terrorism financing". This law is in line with the recommendations of the MONEYVAL Committee of the CE, that were made during the third round of mutual evaluation MONEYVAL -ALBANIA, as well as the FATF recommendations;
- September 2008, the Law no. 9917, May 19, 2008 "On the prevention of money laundering and terrorism financing" became effective;
- September 2009, during the 30th plenary of the MONEYVAL Committee, Albania's two year progress report in the area of money laundering/financing of terrorism prevention, was unanimously approved;
- September 2009, the Twinning Project "Tackling money laundering and financial crime" in cooperation with the German Federal Criminal Office, was completed;
- In October of 2009, the Council of Ministers approved by decision no.1077, of October 2009, the National Strategic Document "On the investigation of financial crime" .GDPML had the leading role in the drafting of this document;
- In November 2009, GDPML presented to the Parliamentary Commission on National Security its activity for the last two years in the area of prevention of money laundering and financing of terrorism;

HYRJE

Viti 2009 është karakterizuar nga zhvillime të rëndësishme për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe për mbarë institucionet shqiptare të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Këto zhvillime kanë synuar në forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të Njësisë së Inteligjencës Financiare Shqiptare dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, intensifikimin e kooperimit ndërinstitucional, si dhe në rritjen e efektivitetit të shkëmbimit të informacionit me agjencitë homologe brenda dhe jashtë vendit.

Në raportin e progresit të vitit 2009 të Bashkimit European për Shqipërinë janë pasqyruar zhvillimet në këtë fushë të Njësisë së Inteligjencës Financiare. Nga krahasimi me raportin e progresit të vitit 2008, ku përmenden si suksese përmirësimi i kushteve të godinës dhe pajisjeve, në raportin e vitit 2009 evidentohen si suksese rritjet e kapaciteteve teknike dhe administrative të DPPP-së, rritja në numër dhe cilësi e inspektimeve të kryera, si dhe rritja e numrit të çështjeve që ka referuar DPPP në prokurori.

Gjatë vitit 2009, DPPP ka vazhduar të jetë e angazhuar në mënyrë serioze në thellimin e bashkëpunimit me subjektet raportuese të ligjit dhe në veçanti, me institucionet bankare në vend. Kjo është arritur me anë të organizmit në bashkëpunim dhe me autoritetet mbikqyrëse/licencuese dhe organizmat ndërkombëtarë që operojnë në Shqipëri, të veprimtarive të trajnimit me kategori të caktuara të këtyre subjekteve. Impakti i këtyre veprimtarive ka qënë i ndjeshëm jo vetëm në rritjen e nivelit të zbatimit të detyrimeve ligjore nga ana e subjekteve, por dhe në forcimin e mëtejshëm të kuadrit institucional në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri.

Instalimi dhe zbatimi i programit analitik ka qënë një element i rëndësishëm për konsolidimin e mëtejshëm të kapaciteteve në fushën e teknologjisë dhe analizës së informacionit. Në këtë kontekst, DPPP ka intensifikuar përpjekjet për mundësimin e raportimit elektronik për

INTRODUCTION

Year 2009 was characterized by important developments for the General Directorate for the Prevention of Money Laundering (GDPML) and all the institutions involved in the fight against money laundering and financing of terrorism. These developments have aimed at further strengthening the professional capabilities of the Albanian Financial Intelligence Unit and other law enforcement agencies, increase of the inter-institutional cooperation, as well as the increase of the effectiveness in the exchange of information with partner institutions within and outside of the country.

The developments of the Financial Intelligence Unit have been reflected also in the European Union's 2009 Progress Report for Albania. In comparison to the 2008 report where improvements of the premises and equipments were highlighted, the 2009 report points out the increase of the technical and administrative capabilities of the GDPML, the quantitative and qualitative increase of the inspections carried out as well as the increase of the number of cases that GDPML has referred to the prosecution.

During 2009 GDPML has continued to be seriously engaged in the enhancement of the cooperation with the legally obliged entities, in particular with the banking institutions in the country. This was achieved thanks to the cooperation with the supervisory/licensing authorities and the international organizations operating in Albania, training activities with several groups of those obliged entities. These activities have had a significant impact not only with regard to the increase of the level of compliance with the legal obligations but also in further strengthening the institutional framework in the domain of prevention of money laundering and financing of terrorism in Albania. The installation and implementation of the analytical program has been an important element for the further consolidation of the capabilities of information technology and analysis. In this framework, GDPML has intensified its efforts to enable online reporting for a number of obliged entities, that has had a direct impact on the effectiveness of the collection, storing and process-

një sërë subjektsh të ligjit, gjë që ka ndikuar në mënyrë direkte në efektivitetin e marrjes, ruajtjes dhe përpunimit të informacionit, që është vënë në dispozicion të analistëve.

Gjatë vitit 2009, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe strukturat e saj janë përballur me një sërë sfidash:

- Rritjen e konsiderueshme të raportimeve të transaksioneve të vlerave nga subjektet e ligjit;
- Finalizimin e hartimit të akteve nënligjore dhe formularëve përkatës të raportimit;
- Hartimin e Strategjisë Kombëtare “Për hetimin e krimit financiar”;
- Monitorimin dhe asistimin profesional të një pjese të madhe të subjekteve raportuese të ligjit;
- Instalimin dhe vënien në përdorim të teknologjisë së re të informacionit për DPPP- në;
- Mundësimin e raportimit elektronik dhe në kohë reale të të dhënave nga subjektet e ligjit;
- Vonesat në dhënien e informacionit dhe feedback nga disa institucione dhe agjenci, në funksion të hetimeve financiare;

Krahas përmbushjes së detyrave të përditshme dhe përballjes me sfidat e sipërpërmendura, DPPP ka qenë gjithashtu institucioni drejtues për zbatimin dhe finalizimin e projektit të binjakëzimit me Policinë Kriminale Federale (BKA), gjë që ka kërkuar angazhimin shtesë të personelit në përmbushjen e detyrimeve, që parashikonte ky projekt për palën shqiptare.

ing of the information at the disposal of the analysts.

In 2009, the General Directorate for the Prevention of Money Laundering and its structures have had to cope with several challenges:

- The considerable increase of the value transaction reports from the obliged entities;
- Conclusion of the drafting of bylaws and their relevant forms;
- Formulation of the National Strategy “On the investigation of the financial crime”;
- Overseeing and assisting professionally a large number of legally obliged reporting entities;
- Installation and implementation of the information technology within GDPML;
- Enabling the real time electronic data reporting of the obliged entities;
- Delays in providing information and feedback related to financial investigations, by some institutions and agencies;

Alongside the fulfillment of the daily tasks and confronting the aforementioned challenges, GDPML has simultaneously been the leading institution for the implementation of the twinning project with the colleagues of German Federal Criminal Office (BKA) that has required additional commitment from the staff in accomplishing the obligations of Albanian institutions foreseen in the project.

ZHVILLIMET KRYESORE DHE ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE TË PASTRIMIT TË PARAVE



MAIN DEVELOPMENTS AND THE IMPLEMENTATION OF
MEASURES AGAINST MONEY LAUNDERING

REFORMA LEGJISLATIVE

Hyrja në fuqi, më 10 shtator 2008, e Ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", intensifikoi përpjekjet e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të hartuar e vënë në zbatim aktet nënligjore. Grupet e punës në DPPPP, të ngritura në bazë drejtorie, kanë punuar për hartimin e drafteve në bashkëpunim me subjektet e ligjit (banka, noterë, avokatë, etj.), shoqatave që përfaqësojnë ato (Shoqata e Bankave të Shqipërisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, etj.), si dhe me autoritetet licencuese e mbikqyrëse.

Me të njëjtën frymë bashkëpunimi e koordinimi është punuar edhe në përpilimin e akteve nënligjore për mënyrat dhe procedurat e raportimit nga institucionet shtetërore si: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave e Ndërtimeve Informale.

Projektet e akteve nënligjore i janë paraqitur Ministrisë së Financave që në fund të vitit 2008 dhe në muajin shkurt 2009, përfundoi procesi i miratimit të tyre nga Ministri i Financave, si më poshtë:

1. Udhëzim nr. 11, datë 05.02.2009, "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jo financiare".
2. Udhëzim nr. 12, datë 05.02.2009, "Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të Ligjit nr. 9917, datë 19. 05. 2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".
3. Udhëzim nr. 15, datë 16.02.2009, "Për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në sistemin doganor".
4. Udhëzim nr. 16, datë 16.02.2009, "Për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave".

Në muajin prill 2009, pas diskutimit e shqyrtimit në ministrinë dhe dikasteret përkatëse, janë miratuar edhe dy akte të tjera nënligjore nga Këshilli i Ministrave:

1. Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 01.04.2009, "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të subjekteve, Agjencia e Legalizimit,

LEGISLATIVE REFORM

Upon entering into force on September 10th 2008, of the Law no.9917 "On the prevention of money laundering and financing of terrorism", the efforts of the General Directorate for the Prevention of Money Laundering regarding the formulation and implementation of the bylaws, were intensified. The working groups established at directorate level within GDPML, have endeavored to develop the drafts in cooperation with the obliged entities (banks, notaries, lawyers, etc), their representative associations (Albanian Banker's Association, National Chamber of Notaries) as well as the licensing and supervisory authorities.

In the same spirit of cooperation and coordination was acted in the formulation of bylaws with regard to reporting by the state institutions such as the General Directorate of Customs, General Directorate of Taxation, Central Office for the Registration of Immovable Property, Agency for the Legalization, Urbanization and Integration of the Informal Construction Areas.

The draft bylaws have been presented to the Ministry of Finance by the end of 2008 and the process of their approval by the Minister of Finance was finalized in February 2009, as follows:

1. Instruction no. 11 February 05, 2009 "On reporting methods and procedures of non financial professions".
2. Instruction no. 12 April 05, 2009 "On the reporting methods and procedures of the obliged entities pursuant to law no. 9917, May 19th 2008 "On the prevention of money laundering and financing of terrorism".
3. Instruction no.15, February 16th. 2009 "On the prevention of money laundering and fight against the financing of terrorism from the customs authorities".
4. Instruction no.16, February 16, 2009 "On the prevention of money laundering and fight against the financing of terrorism from the tax authorities".

In April 2009, upon conclusion of deliberation in the Ministries and other partner institutions the Council of Ministers approved two more bylaws:

Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 08.04.2009, “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit nga autoritetet mbikqyrëse dhe/ose licencuese”.

Me miratimin e këtyre akteve nënligjore dhe botimin e tyre në Fletoren Zyrtare, është plotësuar kuadri ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili ka qenë një ndër rekomandimet e shprehura edhe në raportin e progresit të vitit 2008 të BE-së për Shqipërinë.

Megjithatë, DPPP e konsideron reformën ligjore si një proces dinamik dhe të vazhdueshëm, duke vlerësuar në çdo hap implementimin e këtij legjislacioni, vështirësitë që janë hasur, si nga subjektet raportuese ashtu dhe nga inspektimet në terren, për të bërë propozimet përkatëse për amendime. Mbi këtë bazë, që në muajin nëntor 2009 është ngritur një grup pune ‘ad hoc’ për të draftuar ndryshimet e mundshme legjislative, të akteve ligjore e nënligjore, duke vazhduar kështu përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit.

RAPORTIME NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe atyre të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, në vitin 2009, DPPP-ja ka raportuar disa herë përpara disa strukturave dhe komisioneve të rëndësishme si:

KOMISIONI I SIGURISË KOMBËTARE NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

Më 4 nëntor 2009, Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit

1. Council of Minister’s Instruction no. 1 April 04, 2009 “On the form, methods and procedures of reporting the data of the entities, Agency for the Legalization, Urbanization and Integration of Informal Areas/Constructions and the Central Office for the Registration of Immovable Property, regarding the prevention of money laundering and the financing of terrorism”

2. Council of Minister’s decision no. 343, April 08, 2009, “On reporting methods and procedures of the licensing and/or supervisory authorities”.

Upon the approval of the bylaws and their publication in the official gazette, the legal framework in the area of prevention of money laundering and financing of terrorism was complete. This has also been one of the recommendations expressed in the 2008 European Union Progress Report for Albania.

Nonetheless, GDPML considers the legal reform as a continuous and dynamic process that requires an evaluation in every step of the implementation of the legislation as well as difficulties encountered from the obliged entities and onsite inspections in order to make the necessary proposals for amendments. To this end in November 2009, an ad hoc group was established in order to draft the potential legislative amendments and ensure thus the approximation of the Albanian legislation in the domain of prevention of money laundering and financing of terrorism, with the *acquis communautaire*.

REPORTS IN THE FRAMEWORK OF THE FIGHT AGAINST MONEY LAUNDERING

GDPML, with regard to implementation of the legal obligations and commitments based on international agreements that the Republic of Albania is party to, has reported several times to the following structures and commissions:

NATIONAL SECURITY COMMISSION OF THE PARLIAMENT OF ALBANIA

On November 4th 2009, the General Director of the GDPML, reported

të Parave raportoi për veprimtarinë dy-vjeçare të DPPP-së në një seancë dëgjimore para Komisionit të Sigurisë Kombëtare, në Kuvendin e Shqipërisë, ku u paraqitën arritjet më të spikatura në numrin e raportimeve të dërguara në Policinë e Shtetit dhe Prokurori, si dhe puna parandaluese e DPPP-së me zbatimin e mekanizmit ligjor të bllokimeve paraprake. Seanca ishte e hapur për mediat, si dhe kishte të ftuar përfaqësues të institucioneve të tjera informative e ligjzbatuese, të organizatave kombëtare e ndërkombëtare me qendër në Tiranë, si dhe aktorë të shoqërisë civile.

Pas prezantimit u bënë pyetje dhe komente nga deputetët, përfaqësuesit e EURALIUS dhe të shoqërisë civile. Kryetari i Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, si dhe anëtarët e këtij komisioni, vlerësuan punën e kryer gjatë periudhës raportuese nga DPPP, si dhe rezultatet e arritura nga Njësia e Inteligjencës Financiare Shqiptare në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Vlerësimet për punën e kryer nga DPPP, iu bënë me dije, në seancën plenare të datës 5 nëntor 2009, të gjithë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, nga Kryetari i Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, Zoti Leonard DEMI, duke theksuar se këto arritje të DPPP-së janë të pasqyruara edhe në Raportin e Progresit 2009 të BE-së për Shqipërinë, si dhe në deklaratën për shtyp të datës 29 shtator 2009, të Delegacionit të Komisionit Europian në Tiranë.

KOMITETI I EKSPERTËVE MONEYVAL I KËSHILLIT TË EUROPËS

Më 23 shtator 2009, në Strasburg, gjatë mbledhjes së 30-të plenare të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Europës u bë vlerësimi i raportit të progresit dy-vjeçar të Shqipërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. DPPP bëri prezantimin e raportit. DPPP kryesoi delegacionin shqiptar në këtë Komitet, duke luajtur një rol primar në përgatitjen e këtij raporti dhe në koordinimin e punës me institucionet e tjera partnere në nivel kombëtar.

Prezantimi i raportit të progresit nga ana e delegacionit u bë në mënyrë të detajuar dhe koherente. Përgjigjet që ju dhanë pyetjeve të delegacionit të Monakos, i cili ishte caktuar në rolin e vendit raportues, kontribuan në

in a hearing session before the National Security Commission of the Parliament of Albania, about the two year activity of the institution. Outstanding achievements regarding the number of the referrals to the State Police and Prosecution were presented as well as GDPML's preventive work through the implementation of the legal mechanism of freezing orders. This session was open to media and representatives of other informative, law enforcement agencies, national and international organizations headquartered in Tirana and actors of the civil society were invited.

Upon the conclusion of the presentation questions and comments were made by the members of the parliament, representatives of EURALIUS and civil society. The Chairman of the National Security Commission and its members appreciated GDPML's performance during the reporting period as well as the results achieved by the Albanian Financial Intelligence Unit in the domain of the prevention of money laundering and financing of terrorism.

During a plenary session on November 5th 2009, the Chairman of the National Security Commission, Mr. Leonard DEMI informed all the members of the parliament about these GDPML's achievements, emphasizing the fact that these results were reflected in the 2009 Albania's Progress Report of the European Union as well as the press release of September 29th 2009, of the European Commission Delegation in Tirana.

COMMITTEE OF EXPERTS MONEYVAL OF THE COUNCIL OF EUROPE

On September 23rd 2009, during the 30th plenary session of the Council of Europe's MONEYVAL Committee Albania's two year progress report in the area of prevention of money laundering and terrorism financing was taken into consideration. This report was presented by GDPML, which was also leading the Albanian Delegation to this Committee, and had a prominent role concerning the preparation of this report as well as the coordination with other national partner institutions.

The presentation of the progress report from the delegation was done in a detailed and coherent manner. The responses given to questions by

informimin e mëtejshëm të ekspertëve në lidhje me çështje të caktuara të raportit. Raporti iu nënshtrua një analize të detajuar të anëtarëve të seancës plenare dhe në vijim të përgjigjeve të dhëna nga ana e delegacionit tonë u miratua me unanimitet të plotë.

Seanca e vlerësimit të raportit të progresit të Shqipërisë u ndoq dhe nga Ambasadorja e Shqipërisë në Këshillin e Europës, Znj. Margarita GEGA si dhe Zv/Ambasadori Z. Fotion PENI, të cilët e vlerësuan veçanërisht paraqitjen e bërë nga delegacioni shqiptar. Në vijim të vlerësimeve reciproke që po ndërmerr Komiteti i ekspertëve MONEYVAL është përcaktuar që në nëntor 2010 do të zhvillohet dhe raundi i katërt i vlerësimit të Shqipërisë.

KOMITETI NDËRMINISTROR PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

DPPPP ka marrë pjesë dhe ka raportuar në disa takime periodike të Komitetit Ndërinstitucional për Liberalizimin e Vizave, krahas disa ministrive dhe institucioneve qendrore, në kuadrin e plotësimit të detyrimeve të përcaktuara në Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave me Bashkimin Europian. Detyrimet kryesore të DPPPPP-së kanë qenë:

- Drejtimi i procesit të draftimit dhe konsultimit të një strategjie kombëtare “Për hetimin e krimit financiar”;
- Përfundimi brenda vitit 2009 i raportimit on-line nga bankat pranë Autoritetit Përgjegjës;
- Përfundimi i draftimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 9917, duke plotësuar kuadrin ligjor PPP/FT.
- Rritja e shkallës së përdorimit të mekanizmit bllokues ndaj transaksioneve të dyshimta;
- Rritja e nivelit të bashkëpunimit me institucionet ligj-zbatuese.

Këto detyra të ngarkuara janë kryer e raportuar në afat dhe për gjithë këtë veprimtari, Kryeministri SHTZ Sali BERISHA, si Kryetar i këtij Komiteti e ka veçuar dhe konfirmuar si të suksesshme punën e kryer nga DPPPP në objektivat e përcaktuara, duke vënë gjithashtu theksin te pasqyrimi i duhur edhe për publikun i të gjitha arritjeve të institucioneve shqiptare, jo vetëm në këtë fushë.

the Monegasque delegation designated as a reporter country did contribute to further inform the experts with regard to specific topics of the report. The report underwent a detailed review by the members of the plenary session and was afterwards unanimously approved.

The session of the evaluation of Albania’s progress report was also attended by the Albania’s Ambassador to the Council of Europe Mrs. Margarita GEGA and the deputy Ambassador Mr. Fotion PENI, who did particularly value the presentation made by the Albanian delegation. Pursuant to mutual evaluations that the Committee of Experts MONEYVAL is undertaking, the fourth round of evaluation for Albania is set to take place in November 2010.

INTERMINISTERIAL COMMITTEE FOR VISA LIBERALIZATION

GDPML has participated and reported in several periodic meetings of the Inter-Institutional Committee for Visa Liberalization, along with several Ministries and central institutions, in the framework of completion of obligations defined in the European Unions’ Visa Liberalization roadmap. The main GDPML obligations are:

- Guiding the drafting and consultations process relevant to the strategy “On the investigation of financial crime”;
- The completion within 2009, of bank’s online reporting to the Responsible Authority (GDPML);
- The conclusion of the drafting and the approval of the secondary legislation for the implementation of the Law 9917, complementing thus the legal AML/FT framework.
- The increase of the level of application of temporary freezing mechanisms regarding suspicious transactions;
- The enhancement of the cooperation with law enforcement institutions.

Those obligations have been duly complied with and all GDPML’s activity regarding the defined objectives, has been highlighted and confirmed as particularly successful by the Chairman of this Committee, His Excellency, the Prime Minister Sali BERISHA, who has also emphasized the need to properly convey to the public all the achievements of the Albanian institutions in this field and beyond.

PUNA ME PROJEKTET

Gjatë vitit 2009, personeli i DPPP-së është përfshirë tërësisht në zbatimin e dy projekteve, të mundësuar falë mbështetjes së Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe pikërisht ai i binjakëzimit me Zyrën Kriminale Federale Gjermane, si dhe projekti i dizenjimit të një programi analitik.

Faza e zbatimit të projektit u konkludua gjatë vitit 2009 dhe personeli i DPPP-së ka filluar tashmë aplikimin praktik të këtij programi, i cili krijon mundësi të reja për specialistët e Sektorit të Analizës, në drejtim të administrimit të integruar të çështjeve që i nënshtrohen një analize të detajuar të të gjitha të dhënave përkatëse dhe në këtë mënyrë, tashmë ka filluar të ndikojë në raportet që ju dërgohen agjencive të zbatimit të ligjit.

Projekt tjetër mjaft i rëndësishëm, ku DPPP për herë të parë ka luajtur edhe rolin drejtues për institucionet shqiptare, është ai i Binjakëzimit me Zyrën Federale Kriminale Gjermane (BKA), që ka filluar në vjeshtën e vitit 2007 dhe përfundoi në fund të shtatorit 2009. Ky projekt titullohej “Lufta kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar në Shqipëri” dhe ndërthurte katër komponentë: “Bashkëpunimi”, “Funksionimi i DPPP-së”, “Trainimet” dhe “Planifikimi dhe Zhvillimi”.

Institucionet përfituese të këtij projekti, përveç Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, ishin: Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Objektivat kryesorë të Projektit të Binjakëzimit ishin:

- Arritja e rezultateve konkrete në luftën kundër krimit të organizuar;
- Rritja e koordinimit midis organeve të prokurorisë dhe policisë;
- Përmirësimi i mbikqyrjes së sektorit financiar dhe marrja e masave për formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë;
- Rritja e kapaciteteve të Njësisë së Inteligjencës Financiare, Njësisë së Përbashkët të Hetimit në Prokurori dhe Drejtorisë së Luftës Kundër Krimit Ekonomik në Polici;

PROJECTS' IMPLEMENTATION

GDPML staff during 2009 was also fully involved in the implementation of two projects, made possible through the support of European Union Delegation and namely the twinning project with the German Criminal Federal Office as well as the implementation of an analytical project.

The implementation stage of this project was concluded during 2009 and the GDPML personnel has begun already the practical application of this program that creates new possibilities for the specialists of the Analysis Section, with regard to integrated management of the cases that undergo a detailed analysis of all the relevant data having already yielded tangible results in the reports that are referred to law enforcement agencies.

The twinning project with German Criminal Federal Office (BKA) that commenced in 2007 and was concluded in 2009 was another very important project, with GDPML being the leading Albanian institution. The project titled “Tackling money laundering and financial crime in Albania” did include four components “Cooperation”, “Functioning FIU”, “Training” and “Planning and development”.

In addition to the General Directorate for the Prevention of Money Laundering the beneficiary institutions were: the General Prosecutor’s Office, General Directorate of the Police, General Tax Directorate and the General Custom’s Directorate.

The main objectives of the Twinning Project were:

- Achieving tangible results in the fight against organized crime;
- Enhancement of the coordination among the prosecution and the police;
- Betterment of the financial sector oversight and further formalization of the economy;
- Enhancement of the capabilities of the Financial Intelligence Unit, Joint Investigation Unit in the Prosecutor’s Office and the Police Directorate for the Combat Against Economic Crime;

- Ndërmarrja e hapave të mëtejshëm për përafrimin e kuadrit ligjor me standartet ndërkombëtare;
- Marrja e masave të mëtejshme për ndërtimin e sistemeve të koordinuara për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit.

- Undertaking additional steps to approximate the legal framework with the international standards;
- Introduction of measures for the establishment of coordinated systems for the collection and processing of the information.

Aktivitetet e zhvilluara në kuadrin e projektit dy vjeçar të binjakëzimit, paraqiten në mënyrë të detajuar dhe të ndarë sipas viteve dhe komponentëve në tabelën e mëposhtme:

A detailed breakdown of the activities conducted during the two year timeframe of the twinning project is presented in the table hereunder:


Komponentët/Components	Tema/Subject	Viti/Year 2008	Viti/Year 2009
Komp. 1/Comp. 1	Bashkëpunimi /Cooperation	4	4
Komp. 2/Comp. 2	Funksionimi i DPPPP/Functioning of FIU	6	9
Komp. 3 /Comp. 3	Trajnimet / Training	21	20
Komp. 4 /Comp. 4	Planifikimi dhe Zhvillimi/Planning and Development	8	4
Mbledhjet e Komitetit Drejtues / Steering Committee Meetings		4	4
TOTALI / TOTAL		43	41

Risi për vitin e dytë të projektit të binjakëzimit është rritja e numrit të vizitave studimore, bazuar kjo edhe në propozimet e herëpashershme që ka paraqitur DPPPP në takimet periodike të Komitetit Drejtues. Ekspertë të DPPPP-së kanë marrë pjesë në një sërë vizitash studimore të zhvilluara në njësitë homologe të inteligjencës financiare në Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikë dhe Gjermani, të cilat kanë shërbyer për t'u njohur me përvojën në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në këto vende, me legjislacionin respektiv dhe me zbatimin e tij në praktikë.

The increase of the number of study visits based on the continuous GDP-ML proposals made during the Steering Committee meetings constitute a novelty during the second year of the twinning project. GDPML experts have participated in several study visits in the Financial Intelligence Units in the United Kingdom, Belgium and Germany whereby they have further advanced their experience in the domain of prevention of money laundering and financing of terrorism in those countries as well as the practical implementation.



Një numër i konsiderueshëm i ekspertëve të institucioneve të tjera përfituese kanë marrë pjesë në disa vizita studimore, ku kanë parë nga afër punën e homologëve të tyre në Gjermani dhe kanë marrë përvojat më të mira në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe të koordinimit ndër-institucional. Në rolin e institucionit drejtues, gjatë gjithë periudhës dy- vjeçare (2007 - 2009) të zbatimit të këtij projekti, DPPPP ka punuar seriozisht në organizimin e veprimtarive,



A considerable number of experts from other beneficiary institutions have participated in several study visits where they have closely seen the operational activities of their colleagues in Germany and at the same time they acquired best practices in the domain of anti-money laundering and inter-institutional coordination.

GDPML, in its capacity as the leading institution has worked earnestly during this two

në njohjen e personave kyç të institucioneve përfituese, në shtrirjen e efektit të këtij projekti përtej institucioneve të përcaktuara në kontratën e binjakëzimit, në shkëmbimin e vazhdueshëm të mendimeve me kolegët gjermanë, në përfshirjen e ideve dhe sugjerimeve të institucioneve shqiptare për veprimtari të reja, si dhe në njohjen reciproke të metodave dhe procedurave të punës.

Në veprimtarinë përmblylëse të projektit, organizuar në Durrës më 29 shtator 2009, realizimi i projektit të binjakëzimit u konsiderua i suksesshëm nga Ambasadori i Delegacionit të Komisionit Europian në Tiranë, SHTZ. Helmuth LOHAN, nga ekipi drejtues i projektit dhe nga drejtuesit e institucioneve përfituese.

Hartimi i një strategjie afatmesme dhe afatgjatë për luftën kundër pastrimit të parave dhe krimeve financiare ka qenë një ndër objektivat kryesore të projektit. Ky proces drejtohej nga ekspertët më me përvojë të DPPPP-së, të cilët krahas koordinimit të punës më ekspertët kyç të institucioneve partnere kanë dhënë kontributin e tyre në të gjitha takimet e zhvilluara për këtë qëllim. Një draft përfundimtar i dokumentit strategjik u konkludua gjatë takimit të grupit të punës së ekspertëve shqiptarogjermanë, organizuar në shtator të vitit 2009 në Berlin.

Në tetor 2009, në një takim të posaçëm, organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme, dokumenti strategjik iu paraqit institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare në Shqipëri, mendimet dhe sugjerimet e të cilave u reflektuan në versionin përfundimtar, i cili u miratua me Vendimin nr. 1077, datë 27.10.2009, të Këshillit të Ministrave. Dokumenti përmban një plan të detajuar veprimi me objektiva dhe veprimtari të përcaktuara qartë, zbatimi i të cilave do të bëhet nga secili prej institucioneve partnere, të cilët kanë përcaktuar tashmë dhe ekspertët kyç për monitorimin e këtij procesi. Ky dokument strategjik është botuar dhe iu është shpërndarë të gjitha institucioneve të përfshira në implementimin e tij.

year project's implementation period (2007 - 2009) with regard to organizing the training activities, informing the key institutional experts with those activities, extending the effect of this project beyond the institutions designated in the twinning contract, continuous exchange of opinions with the German colleagues with regard to inclusion of ideas and suggestions of Albanian institutions concerning new activities as well as the mutual knowledge exchange of operational methods and procedures.

During the closing event of this project that was organized on September 29th in Durres, the completion of this twinning project was regarded as successful from the Ambassador of European Delegation in Tirana, His Excellency. Helmuth LOHAN, the project team as well as directors of beneficiary institutions.


Drafting of a medium and long term strategy for combating money laundering and financial crime has been one of the main objectives of this project. This process was led by the most experienced specialists of GDPML, who along with the coordination of tasks with key experts of partner institutions have afforded their contribution in all the meetings that have taken place to this end. A final draft of the strategic document was completed during the meeting of the Albanian-German working group, held in Berlin in September of 2009.

The strategic document was presented in October 2009, during a special meeting held in the General Prosecutor's Office, to institutions and international organizations in Albania. Their opinions and suggestions were duly included in the final version which was approved by the Council of Ministers with Decision No.1077, October 27, 2009. The document contains a detailed action plan with clearly defined objectives and activities, to be implemented by the partner institutions that have already appointed key experts to observe this process. This strategic document is published and has been distributed to all the institutions involved in its implementation.

MENAXHIMI I BURIMEVE DHE PERFORMANCËS

Edhe gjatë vitit 2009, DPPPP dhe strukturat e saj përbërëse kanë kryer menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike. Ndryshim kryesor përsa i përket burimeve njerëzore përbën miratimi i shtesës së limitit organik nga 22 në 26 punonjës në qershor 2009, duke rritur drejtpërdrejt numrin e analistëve dhe specialistëve të teknologjisë së informacionit.

Struktura organike e DPPPP-së:




Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve ka ndjekur procedurat që parashikon Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Për Statusin e Nëpunësit Civil" për të rekrutuar pesë punonjës në pozicionet: Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit, Përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit, Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Specialistë në Sektorin e Analizës. Sektori ka ndjekur dhe monitoruar nga afër procedurat e marrjes së masave disiplinore dhe largimin e një punonjësi të nivelit drejtues.

MANAGEMENT OF RESOURCES AND PERFORMANCE

During 2009, GDPML and its internal structures have performed the management of human, financial and logistic resources. The approval in June 2009, of the staff additions from 22 to 26 employees in the current organic structure, remains the major change that has directly increased the number of analysts and information technology specialists.

GDPML's Organizational Chart



The Section for the Management of Human Resources and Services has performed the procedures prescribed in the Law no.8549, of November 11, 1999 "On the status of civil servants" in order to recruit five employees in the following positions Director of Inspections Department, Head of Legislation Department, Head of Analysis Section and specialists in the Analysis Section. The section has closely followed and monitored the procedures of disciplinary actions and the dismissal of an employee in a leading position.

Po kështu, ky sektor ka ndjekur procesin e vlerësimit të punës dhe performancës së çdo punonjësi në DPPP, janë evidentuar dhe plotësuar dosjet me masat disiplinore, që janë marrë kundrejt punonjësve, si dhe me shpërblimet e diferencuara për punonjësit më të mirë. Rëndësi e posaçme i është kushtuar plotësimit të detyrimeve ligjore në fushën e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe shmangies së konfliktit të intereseve, duke raportuar në ILDKP.

Në bashkëpunim me sektorët e tjerë të DPPP-së, është punuar për “Planin e Integruar të Ministrisë së Financave për vitin 2009”, progresin e arritur në lidhje me objektivat strategjike të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale gjatë vitit 2008 për DPPP-në, në kuadër të Raportit Vjetor të Rezultateve të Ministrisë së Financave për vitin 2008, Programin e DPPP-së për 4 vitet e ardhshme mbi reformat dhe objektivat bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, si dhe në Strategjinë Sektoriale të Financave Publike.

Po ashtu, është bërë i mundur plotësimi i dokumentacionit për pajisjen e punonjësve të rinj të DPPP-së me certifikata të sigurisë nga DSIK, që i lejon të njihen me dokumentacion të klasifikuar “sekret shtetëror”. Progresi i arritur në këtë drejtim nga DPPP është cilësuar edhe në Raportin e Inspektimit për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fushën e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të DSIK.

Gjatë vitit 2009 janë zbatuar të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me trajnimin e ofruar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, në përfundim të të cilit janë kualifikuar nëntë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Personeli i DPPP-së, krahas angazhimit total në trajnimet e zhvilluara në kuadër të projektit të binjakëzimit, si dhe të projektit ILECU, ka marrë pjesë edhe në trajnimet e organizuara nga JVI në Vjenë dhe UNODC në Tiranë, për analistët dhe specialistët e teknologjisë së informacionit.

Burimet buxhetore dhe përdorimi i tyre nga DPPP

Që prej vitit 2005, kur Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave u ngrit në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, në zbatim të Vendimit të Këshillit të

The section has also overseen the evaluation procedures regarding the activity and performance of each GDPML employee, maintained detailed documentary evidence regarding the disciplinary actions applied as well as the differentiated remunerations for the best employees.


The cooperation with other departments in the GDPML has been continuous with regard to “The integrated Plan of the Ministry of Finance for the year 2009”, the progress achieved in connection with the GDPML’s strategic objectives set down in the sectorial and cross cutting strategies for 2008, in the framework of Annual Report of the Ministry of Finance for 2008, GDPML’s program for the following four years included in the National Strategy for Development and Integration as well as the Public Finances’ Strategy.

The completion of the documentation and the issuing of DSCI security certificates for the new GDPML’s employees that allows them to get acquainted with documents classified as “state secret”. The progress achieved in this regard has also been reflected in the DSCI Inspection’s Report with reference to the implementation of the legal framework concerning DSCI information classified as “state secret”.

All the relevant procedures related to the training activities offered by the Institution for the Training of the Public Administration for nine employees of the General Directorate for the Prevention of Money Laundering have been completed. GDPML’s staff in addition to the engagement in the training activities offered in the framework of the twinning project, and those provided by ILECU, has also attended the training sessions offered for analysts and information technology specialists organized by JVI in Vienna as well as UNODC in Tirana.

Budgetary resources and their use by GDPML

Since 2005, when the Directorate for the Coordination of the Fight Against Money Laundering was upgraded to a General Directorate for the Prevention of Money Laundering, in accordance with the Decision



Ministrave, nr. 108 datë 11.02.2005 “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit të pagave të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”, kjo drejtori kaloi me buxhet dhe llogari më vete, duke filluar nga 1 gushti 2005. Fondet e akorduara në Buxhetin e Shtetit nga ajo kohë deri më sot paraqiten në grafikun e mësipërm.

Siç duket qartë nga të dhënat grafike, fondet në dispozicion kanë qenë të mjaftueshme aq sa asnjëherë nuk janë realizuar në masën e tyre të plotë, pavarësisht disa uljeve në vitet 2007 e 2009, gjë që konfirmon prioritetin që i ka kushtuar Qeveria Shqiptare Njësisë së Inteligjencës Financiare dhe në përgjithësi parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

of the Council of Ministers no.108 February 11, 2005 “On the manner of the organization and functioning of the General Directorate for the Prevention of Money Laundering” this directorate had separate budget and accounting starting from August 1st, 2005. Funds allocated from the State Budget from then on are represented in the graph above.

As it is clearly seen in the graph the available funds have been sufficient and have never been fully utilized, despite some reductions in 2007 and 2009, which confirms the priority that the Albanian Government has dedicated to the Financial Intelligence Unit and the prevention of money laundering/financing of terrorism in general.

NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE

Rritja e nivelit të njohjes së detyrimeve ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave ka vazhduar të përbëjë një nga prioritetet e punës së DPPPP-së. Për këtë qëllim janë kryer, vetëm ose në bashkëpunim me institucione kombëtare apo ndërkombëtare, trajnime të subjekteve të ligjit, të cilat kanë synuar:

- rritjen e nivelit të njohurive të personave përgjegjës dhe subjekteve për parandalimin e pastrimit të parave në lidhje me legjislacionin në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- zbatimin e mënyrave të reja të raportimit në përputhje me zhvillimet e TI- së në DPPPP;
- prezantimin e përvojave dhe praktikave më të mira në këtë fushë në arenën ndërkombëtare;
- shkëmbimin e ideve me subjektet raportuese dhe njësitë homologe në funksion të rritjes së efikasitetit në dedektimin e rasteve të dyshimta për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

Gjatë vitit 2009, në vazhdimësi, theksi është vënë në marrëdhëniet me publikun në tërësi dhe veçanërisht, në ndërgjegjësimin e subjekteve të ligjit. Publikimi i raportit vjetor të vitit 2008 u krye në një takim më përfaqësues të një sërë institucionesh shtetërore shqiptare dhe organizmave ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri si, PAMECA, INTERFORZA, Oficerët e Kontaktit të Austrisë, Mbretërisë së Bashkuar, Belgjikës, Danimarkës, Greqisë etj. Faqja zyrtare e përditësuar e internetit, e DPPPP-së, është një burim i vyer informacioni për publikun, në lidhje me veprimtarinë e drejtorisë në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjatë vitit 2009, janë zhvilluar takime, biseda, seminare, tryeza të rrumbullakta me shumë shoqata e individë, ku ndër më kryesoret përmendim takimet dhe seminarët me Shoqatën e Bankave të Shqipërisë, me Dhomen Kombëtare të Noterëve, me Shoqatën e Ekspertëve Kontabël, me Dhomen e Avokatëve të Shqipërisë, me Shoqatën e Ndërtuesve Shqiptarë, etj.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten trajnimet dhe seminarët e kryera me subjektet, të cilat kanë detyrim për të raportuar në zbatim të legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, si dhe numrin e personave pjesëmarrës. Në këto të dhëna janë përfshirë edhe subjektet e inspektuara, që kanë përfituar njëkohësisht edhe nga trajnimi i posaçëm për plotësimin e detyrimeve ligjore.

AWARENESS ENHANCING OF THE OBLIGED ENTITIES

The increase of the level of acquaintance with the legal obligations in the domain of prevention of money laundering has continued to be the main priority of the activity of GDPML. To this end the obliged entities have been trained alone or in cooperation with national or international institutions which have aimed at:

- Increasing the level of knowledge concerning the legislation for the prevention of money laundering and financing of terrorism of the compliance persons in charge of money laundering prevention;
- Implementation of new reporting methods in accordance with the IT developments in GDPML;
- Presentation of experiences and best practices in this field in the international arena;
- Exchange of ideas with the obliged entities and partner units in order to increase the effectiveness in the detection of the suspicious cases related to money laundering and financing of terrorism.

During 2009, the emphasis has been placed in public relations in general and sensitization of the obliged entities. To this end served the publication of the 2008 annual report, during a meeting with the representatives of several Albanian state institutions and international organizations, that function in Albania such as PAMECA, INTERFORZA, Liaison Officers from Austria, United Kingdom, Belgium, Denmark, Greece etc .

The continuously updated official website of GDPML is a precious source of information for the public with regard to the activity of the directorate in the national and international level. During 2009, several meetings, discussions, workshops, round tables have taken place with many associations and individuals, among the most important we could mention the ones with the Albanian Banker's Association, National Chamber of Notaries, Association of Public Accountants, Albanian Bar Association, Albanian Builder's Association, etc.

The following table represents trainings and workshops carried out with the obliged entities that have an obligation to report in accordance with the legislation for the prevention of money laundering as well as the number of persons trained. This data also includes the obliged entities that have been inspected that have also benefited from the specific training aiming at the implementation of the legal obligations.

Trajnimet e kryera nga DPPPP / Training conducted by GDPML

Subjekti/Entity	Numri i personave të trajnuar/Number of persons trained
Noterët/Notaries	252
Shoqëritë e Tregimit të Automjeteve/Car dealers	20
Shoqëritë e Qeradhënies/Leasing Companies	10
ZQRPP/CORIP	36
Instituti i Kontabilistëve të Miratuar/ Institute of Attested Accountants	69
Studio Ligjore/Legal Offices	10
Shoqëri ndërtimi/Construction companies	140
ALUIZNI/ ALUIAC	29
Vlerësuesit e pasurive/Real Estate Assessors	11
Institucione Jo-Bankare/Non-Bank institutions	10
Zyra të Këmbimit Valutor/Bureaux de change	7
Shoqëri Sigurimi/Insurance companies	6
Lojëra fati & Kazino/Games of chance & Casino	2
Bankat/Banks	14
Zyra Imobiliare/Real Estate Agents	60
TOTALI/TOTAL	696

Gjatë vitit 2009 janë trajnuar gjithashtu një numër i konsiderueshëm i punonjësve të institucioneve përfutuese të projektit të binjakëzimit, të disa institucioneve mbikqyrëse/licencuese dhe subjekteve raportuese, sipas kategorive të paraqitura në tabelën e mëposhtme, të ndara sipas viteve:

In 2009, a considerable number of employees of beneficiary institutions of the twinning project, as well as licensing/supervisory institutions and obliged entities, have been trained, categorized according to the following tables, in years:

Subjekti / Entity	Numri i të trajnuarve / Number of people trained	
	Viti/ Year 2008	Viti/ Year 2009
I. Përfutues nga Projekti i Binjakëzimit / I.Twinning Project Beneficiaries		
DPPPP / GDPML	15	20
DPD / GDC	74	93
DPPSH / ASP	46	73
PP / PO	32	35
DPT / GDT	38	42
II. Të tjerë / II.Other		
Bankat Tregtare / Commercial Banks	107	65
SHISH/SIS	5	-
BSH / BoA	13	11
AMF/FSA	5	-
IEKA/ICPA	5	-
Kompani transfertash/Money Services Bureaux	-	3
TOTALI / TOTAL	340	342

Totali i personave të trajnuar nga DPPP dhe ekspertët e ardhur nga Gjermania dhe Irlanda e Veriut në kuadër të projektit, gjatë vitit 2009 arrin në 1038 vetë. Trajnimet e kryera, si dhe numri i të trajnuarve, kanë ardhur në rritje dhe kanë ndikuar ndjeshëm në nivelin e përputhshmërisë së subjekteve me legjislacionin në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Marrëdhëniet me institucionet mbikqyrëse/licencuese në 2009 janë intensifikuar nëpërmjet takimeve me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Departamentit të Mbikqyrjes së Bankës së Shqipërisë, si dhe institucione të tjera partnere si, Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, etj.

INSPEKTIMET

Monitorimi i masave parandaluese që duhet të ndërmarrin institucionet financiare e jo-financiare, subjekte të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, mbetet një nga detyrimet themelore të DPPP-së. Ky detyrim realizohet nga Drejtoria e Inspektimit dhe Legjislacionit, e cila ka një rol primar për planifikimin dhe kryerjen e inspektimeve në vend të subjekteve të ligjit. Numri total i inspektimeve të kryera në subjektet e ligjit nga DPPP në vitin 2009 është 146. Ky numër përbën një rritje të ndjeshme krahasuar me 123 inspektimet e kryera në vitin e mëparshëm. Gjatë vitit 2009, specialistët e kësaj Drejtorie kanë vazhduar të intensifikojnë ritmin e inspektimeve në vend të subjekteve. Njëkohësisht theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave të tillë si, raporti i vetëkontrollit, paraqitja e subjekteve në DPPP për rastet kur është konstatuar se ka mangësi në mënyrën e raportimit, etj.

Në planifikimin e inspektimeve në vend, DPPP-ja ka vazhduar të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- Shkalla e ekspozimit ndaj rrezikut të pastrimit të parave të subjekteve;
- Sasia dhe cilësia e informacionit që disponojnë subjektet;
- Inspektimet e subjekteve, të cilat janë konstatuar shkelje nga inspektimet e mëparshme, etj.

Njëkohësisht është rritur niveli i bashkëpunimit me institucionet mbikqyrëse/licencuese, të cilat në bazë të ligjit kanë përgjegjësi të përcaktuara qartë,

The total number of persons trained by GDPML and the experts from Germany and Northern Ireland within the realm of the twinning project during 2009, reaches 1038. Training conducted as well as the number of those trained marks an upward trend and have significantly affected the level of entities' compliance with the current anti-money laundering/financing of terrorism legislation.

The relations with supervisory and licensing institutions in 2009, have been intensified by means of meetings with the representatives of the Ministry of Justice, Central Office for the Registration of Immovable Property, Supervisory Department in the Bank of Albania as well as other partner institutions such as High Inspectorate for the Declaration and Audit of Assets, the Agency for the Administration of Seized and Confiscated Assets, etc.

INSPECTIONS

The preventive measures undertaken by financial and non-financial institutions, as obliged entities under the anti-money laundering/combating of terrorism legislation, remain one of GDPML's primary obligations. This is carried out by the Inspection's and Legislation Directorate that has a crucial role for the planning and conducting on site inspections of the obliged entities. The number of total inspections of obliged entities performed by GDPML in 2009, is 146 and represents a significant increase compared to 123 inspections performed during the previous year.


During 2009, the specialists of this Directorate have continued to intensify the pace of on site inspections of the obligors. At the same time special emphasis has been put on the use of mechanisms such as the Self Auditing Report, notifications of the obligors to appear in GDPML in those cases when reporting infringements by obligors have been identified, etc.

The planning of inspections has continued to be based on the following criteria:

- The level of obligor's exposure to the risk of money laundering;
- Quantity and quality of information held by obligors;
- Inspections of those entities that have previously had violations.

The level of cooperation with the supervisory and licensing institutions has been enhanced. Pursuant to the current legislation those institutions

në lidhje me monitorimin e përmbushjes së kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga kategori të caktuara të subjekteve. Në grafik jepet ecuria e inspektimeve në vite. Krahasuar me vitin e mëparshëm, numri i inspektimeve gjatë 2009-ës ka shënuar një rritje prej 19%. Një gjë e tillë është realizur më të njëjtin numër specialistësh, gjë që dëshmon sërish rritjen e efektivitetit të kapaciteteve njerëzore në këtë Drejtori.



Kontrollet e inspektimet në vend kanë qenë; të plota dhe/ose tematike, bazuar në vlerësimin paraprak të bërë në planin vjetor të punës së DP-PPP- së, si dhe në përdorimin sa më efektiv të burimeve të kufizuara njerëzore. Inspektimet e natyrës së plotë janë kryer në subjektet, të cilat inspektoheshin për herë të parë, ose për vetë natyrën e veprimtarisë së

of effectiveness of human resources in this Directorate. The controls and on-site inspections have been; complete and/or thematic, based on a preliminary evaluations defined in GDPMLs annual plans, as well as the most effective use of limited human resources. Inspections of a full scale type have been carried out in those entities that were being checked for the first time or due to the nature of their activity

have clearly defined responsibilities vis a vis the observance of compliance with the demands of money laundering and financing of terrorism prevention by specific categories of obligors. The graph displays inspection's performance over the years. Compared to the previous year, the number of inspections during 2009, has had a 19% increase. This has been achieved with the same number of specialists being a testimony of a higher level

Subjektet e Inspektuara/Inspected Entities	Vt./Yr.2005	Vt./Yr.2006	Vt./Yr.2007	Vt./Yr.2008	Vt./Yr.2009
Shoqëri Sigurimi/Insurance Companies	7	4	10	6	3
ZQRPP- ZVRPP/CORIP	5	10	5	6	-
Zyra të Këmbimit Valutor/Bureaux de change	-	5	16	5	3
Noterë/Notaries	-	-	17	42	7
Shoqëri Ndërtimi/Construction Companies	-	-	-	5	63
EKA/CPA	-	-	-	13	-
DPT/GDT	-	4	6	1	-
Agjensi Udhëtimesh/Travel Agencies	-	26	-	4	-
Zyra Imobiliare/Real Estate Offices	-	-	-	-	31
Lojra Fati/Games of Chance	-	9	7	11	2
Banka/Banks	-	-	17	7	8
Institucione Jo Bankare/Non Bank Institutions	-	-	3	7	8
OJQ/NPO	-	16	-	1	-
Shoqëritë e qiradhënies financiare/Leasing Companies	-	-	-	3	4
Shoqëritë e tregimit të mjeteve motorike/Car Dealers	-	12	19	12	7
Dept. i Admin. e Shitjes së Pronës Publike/Dept. for Admi. and Sale of Public Property	-	-	1	-	-
Vlerësues të Pasurive të Paluejtshme/Real Estate Assessors	-	-	-	-	5
Avokatët/Lawyers	-	-	-	-	5
DPD/GDC	1	14	-	-	-
TOTALI/TOTAL	13	100	101	123	146


tyre kërkoni një vëmendje më të madhe. Në të gjitha inspektimet e kryera është bërë gjithashtu dhe trajnimi i personave përgjegjës të subjekteve. Të dhënat e detajuara, të kategorizuara sipas grupeve të subjekteve të inspektuara, jepen në tabelën e faqes 27.

Në tabelë jepet një paraqitje e kategorive të subjekteve të inspektuara, numrit të inspektimeve si dhe peshës specifike që i është kushtuar secilës kategori. Siç vërehet, shoqëritë e ndërtimit dhe agjencitë e shitblerjes së pasurive të paluajtshme kanë zënë pjesën kryesore të inspektimve të kryera gjatë vitit 2009, respektivisht 43.5% dhe 20.5% të totalit të inspektimeve. Pavarësisht se theksi është vënë në këto dy subjekte që janë kategorizuar si më të ekspozuara ndaj fenomenit të pastrimit të parave, impakti në nivelin e raportimeve nuk ka qenë i po atij niveli me vitin 2008.

MASAT ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2009, DPPP intensifikoi zbatimin e masave shtrënguese dhe detyrimeve në fushën e parandalimit të pastrimit të parave që kanë subjektet. Në këtë kuadër janë vendosur një numër i konsiderueshëm masash administrative ndaj atyre subjekteve, për të cilat inspektorët e Drejtorisë së Inspektimit dhe Legjislacionit kanë konstatuar shkelje të ligjit gjatë inspektimeve në vend. Numri total i masave të dhëna nga Autoriteti Përgjegjës gjatë vitit 2009 është 37 masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet e ligjit, kundrejt 35 të dhëna për vitin 2008.

Në grafikun e mëposhtëm jepen të dhënat mbi masat administrative në vite. Shuma totale e gjobave të dhëna për vitin 2009 është 69,296,500 Lekë, ose rreth tre herë më shumë se një vit më parë. Gjoha minimale është 250,000 Lekë, gjoha maksimale është 8,000,000 Lekë dhe ajo mesatare është 1,872,878 Lekë.



required greater attention. Training of the compliance persons did also take place in the inspections conducted. The table on page 27 contains detailed data, categorized according to the groups of entities inspected. The table provides a presentation of entities inspected, and the number of inspections.

As it can be noticed the construction companies and the real estate agencies, represent the bulk of inspections carried out during 2009, with accordingly 43.5% and 20.5% of the total of inspections. Although greater attention was paid to those entities that are categorized as more exposed to the phenomenon of money laundering, the impact on the level of reporting has not been at the same level of the year 2008.

ADMINISTRATIVE SANCTIONS

During 2009, GDPML has continued to intensify the functioning of restrictive measures and observance by the entities of the obligations in the realm of prevention of money laundering. In this framework a considerable number of administrative sanctions have been applied, with reference to the violations identified by the specialists of Inspections and Legislation Department during the onsite inspections. The total number of sanctions levied by GDPML for the violations encountered by GDPML during 2009 is 37, compared to 35 for the year 2008.

The following graph provides figures about administrative sanctions over the years. The total amount of sanctions applied in 2009, is 69,296,500 Lek or more the a three fold increase compared to previous year. The minimum sanction is 250,000 Lek, the maximum one is 8,000,000 Lek while the average one is 1,872,878 Lek.

The Legislation's Section has

Sektori i Legjislacionit dhe Trajnimit ka ndjekur me kujdes të gjitha proceset e ankimimit të masave në të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe gjatë vitit 2009, rezultoi të jenë bërë 26 ankimime për masat administrative të dhëna nga DPPPP pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kurse 7 subjekte kanë likuiduar gjobën pa vazhduar procedurat e ankimimit. Në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë janë shqyrtuar 40 çështje gjyqësore me palë të paditur – DPPPP-në, përfshirë këtu edhe për masat e dhëna para 2009-ës. Nga DPPPP janë fituar 14 çështje në shkallën e parë, 2 çështje janë fituar nga subjektet e ndëshkuara dhe 23 çështje janë në proces.

Po kështu, në Gjykatën e Apelit Tiranë, janë fituar nga DPPPP 6 çështje nga 16 apeline të bëra, 10 çështje vazhdojnë të jenë në proces shqyrtimi gjyqësor nga kjo gjykatë. Në Gjykatën e Lartë ndodhet për gjykim 1 çështje, e cila është fituar nga DPPPP në të dyja shkallët e gjykimit. Shkalla e lartë e proceseve gjyqësore të fituara në Shkallën e Parë dhe në Apel vazhdon të mbetet një tregues pozitiv performance i zbatimit rigoroz të ligjit nga ana e DPPPP-së, e konfirmuar kjo edhe me vendimet e disa shkallëve të organeve gjyqësore.

Kontrollin dhe monitorimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit nga subjektet, përveçse nëpërmjet inspektiveve dhe trajnimeve, DPPPP e ka ushtruar edhe nëpërmjet vlerësimit dhe analizimit edhe në këtë optikë të informacionit të grumbulluar në funksion të investigimeve rast pas rasti. RAD-të, RTV-të, informacionet e detajuara të marra mbi bazën ose jo të kërkesave, janë shqyrtuar edhe në pikëpamjen se sa këto dokumente të hartuara nga subjektet raportuese janë konform kërkesave dhe detyrimeve të ligjit. Mbi bazë edhe të këtyre analizave janë inkurajuar subjektet për të vijuar bashkëpunimin, dhe nuk kanë munguar rastet, kur atyre iu është tërhequr vëmendja për mangësi, madje edhe është inicuar procedim administrativ ndaj tyre.

cautiously monitored all the appeal procedures concerning the administrative sanctions in all the levels of the judiciary. In 2009, in 26 cases of administrative sanctions imposed by GDPML, appeals have been lodged with Tirana's Court of First Instance while 7 obligors have paid the sanctions without starting an appeal's procedure. Tirana's First Instance Court has adjudicated 40 cases where GDPML was the defendant, including those for sanctions levied before 2009. First Instance Courts have ruled in favor of GDPML in 14 cases, 2 cases have been won by the plaintiffs while 23 cases are still under consideration by the judiciary.

At the same time GDPML had, 6 rulings in favour out of a total of 16 pleas at the Appeals Court of Tirana while 10 cases are being deliberated by this court. One case is being deliberated by the Supreme Court that was ruled in favour of GDPML by the lower courts. The high level of court cases ruled in favour of GDPML in the Court of First Instance and the Court of Appeals is a positive indicator of performance with respect to meticulous implementation of the law by GDPML, that is reaffirmed by the decisions of the various levels of the judiciary.

The control and monitoring of obliged entities compliance with the legal obligations regarding the prevention of money laundering and financing of terrorism by GDPML, in addition to inspections and training, has been effected by means of evaluations and analysis in light of the information gathered for the investigations on case by case basis. SARs and VTRs, detailed information obtained through requests or obligingly, has been looked into from the point of view of to what degree those reports are in line with the legal requirements and obligations. Based on this analysis the entities have been encouraged to continue cooperation while there have been cases where their attention was drawn regarding deficiencies encountered and at times administrative proceedings were initiated in their regard.

MBLEDHJA, ANALIZIMI DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR



COLLECTION, ANALYSIS AND DISSEMINATION
OF FINANCIAL INFORMATION

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË VEPRIM- TARIVE TË DYSHIMTA NGA SUBJEKTET RAPOR- TUESE

Sipas legjisllacionit të mëparshëm dhe atij aktual, që rregullon regjimin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit në Shqipëri, subjektet kanë detyrimin të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, krahas transaksioneve të vlerave, të gjitha rastet e veprimtarisë së dyshimtë pavarësisht nga shumata e përfshira.

Në vitin 2009, nga subjektet banka janë raportuar 186 RAD. Në krahasim me vitin 2008, gjatë të cilit subjektet e ligjit kanë raportuar 152 RAD, shënohet një rritje prej 22% krahasuar me vitin e mëparshëm. Ndonëse ka rritje, ky numër vazhdon të jetë i ulët, fakt që është evidentuar edhe në raportin e BE-së, të progresit të vitit 2009 për Shqipërinë. Grafiku i mëposhtëm tregon në mënyrë kronologjike fluksin e RAD të raportuara gjatë viteve 2005 - 2009.


Nga grafiku vihet re një rritje graduale e numrit të raportimeve të veprimtarisë së dyshimtë, me oshilacione të theksuara në vitet 2006-2007. Nga vlerësimet që iu janë bërë RAD-ve në raportet vjetore të viteve 2007 e 2008, rezultoi se shumica e tyre kanë të bëjnë me kryerje shkëmbimesh valutore të palicencuara, transaksione të shumëfishta në drejtim të një përfituesi dhe evazion fiskal. Fakti që në vitin 2007, vetëm 1% e totalit të raportimeve RAD janë referuar në organet e zbatimit të ligjit, dëshmon mungesën e elementëve të mjaftueshëm të dyshimit. Nga shqyrtimi dhe analiza e RAD-ve të vitit 2009, 21 (11%) prej tyre kanë rezultuar me elementë të mjaftueshëm dyshimi, të cilat pas investigimit financiar janë referuar për hetime të mëtejshme pranë organeve të zbatimit të ligjit.

REPORTING OF SUSPICIOUS TRANSACTION ACTIVITIES BY THE OBLIGED ENTITIES

Based on the previous and the current legislation that regulates the anti-money laundering and combating of financing of terrorism regime in Albania, the obliged entities must report to the General Directorate for the Prevention of Money Laundering, in addition to value transaction's report, all the suspicious activities regardless of the amount.

A total of 186 SARs have been reported by the banks in 2009. There has been a 22% increase in comparison to 152 SARs reported by the obliged entities in 2008. Despite the increase, this number continues to be low, and this was stated in Albania's progress report 2009 published by EU. The following chart presents chronologically the flow of reported SARs, during 2005 - 2009.

The chart shows a gradual increase of the number of suspicious activity reports, with significant fluctuations during 2006-2007. Upon the evaluations of SARs in the annual reports of 2007, 2008 it can be concluded that an overwhelming number of them are related to performing unlicensed currency exchange operations, multiple transactions directed to one beneficiary and tax evasion. Given the fact that in 2007, only 1% of the total of SARs reports, have been reported to law enforcement agencies, it can be safely deduced that sufficient suspicious elements were lacking. Upon further consideration and analysis of 2009 SARs, 21 (11%) of them did contain sufficient suspicious elements, underwent financial investigation and were referred to law enforcement agencies for further investigation.




Kategorizimi sipas tipologjive i RAD-ve jepet në grafikun e mëposhtëm:

The categorisation of SARs typologies is presented in the following chart:

Duke analizuar në vijimësi dhe në mënyrë të thelluar RAD-të dhe nivelin e përmbushjes së detyrimeve ligjore, për masat parandaluese të PPP/FT prej subjekteve, konstatojmë, se krahas numrit të ulët, vazhdon të mbetet problem shqetësues cilësia dhe përmbajtja e tyre. Nga krahasimi i fluksit mujor të raportimit, vihet re një shpërndarje e shpërpjestuar, me një rritje të theksuar në fund të vitit, si dhe e përqindjes së tipologjive, ku mbi 90% e tyre janë: transferata me jashtë si, shlyerje detyrimi personal dhe përdorimi i llogarive personale për qëllime biznesi, rezulton qartë se dërgimi i raporteve të veprimtarisë së dyshimtë nga bankat është parë kryesisht si objektiv statistikor për tu arritur, se sa si detyrë permanente gjatë gjithë kohës dhe për të gjithë komponentët e veprimtarisë bankare.

Për sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, krahas informacionit të përgjithshëm të pasqyruar në raportin vjetor të veprimtarisë së saj në lidhje me rastet e raportuara ka filluar për herë të parë në vitin 2009 njoftimin e subjekteve të ligjit për raportimet e bëra dhe veçanërisht për raportet, RAD. Ky feedback iu është drejtuar subjekteve raportues dhe njëkohësisht autoriteteve mbikqyrëse dhe licencuese, në mënyrë që edhe këto të fundit të shtojnë nivelin e monitorimit të zbatimit të masave parandaluese, bazuar në nenin 22 të Ligjit nr. 9917. Informimi i subjekteve mbi sasinë dhe cilësinë e raporteve të transaksioneve të dyshimta dhe ecurinë e hetimeve financiare, ka qënë në qendër të vëmendjes së Drejtorisë së Analizës dhe TI. Një praktikë e tillë pune do të intensifikohet më tej gjatë viteve në vazhdim, gjë që do të shërbejë për të orientuar subjektet e ligjit në raportimin që ato bëjnë në DPPPP dhe për rrjedhojë, do të avancojë efektivitetin e përdorimit të burimeve njerëzore të DPPPP-së.



Based on a continuous and far reaching analysis of SARs and the level of compliance with legal obligations regarding the AML/FT preventive measures, we notice that the low level of reports and their low quality are a matter of concern. As a result of comparisons of monthly flows, a disproportionate distribution can be observed with a significant increase at the end of the year. More than 90% of the typologies encountered is related to outbound wire transfers for

the settlement of personal debts as well as the use of personal accounts for business purposes. It can therefore be safely stated that the filing of suspicious activity reports by the banks is perceived more as a statistical goal to be achieved rather than a lasting commitment encompassing the whole banking activity.

Given the above the General Directorate for the Prevention of Money Laundering, has started for the first time in 2009, to in addition of the general information regarding the reported cases, represented in the annual report of its activity, inform the obliged entities with respect to reports in general and SARs in particular. This feedback has been directed towards the obliged entities and the supervisory/licensing authorities, in order for the latter ones to increase the level of monitoring of the compliance with preventive measures, pursuant to article 22 of the Law 9917. The Analysis and IT Directorate has paid special attention to the information of the obliged entities about the quality and quantity of the suspicious transactions reporting and the financial investigations. This procedure will be further intensified in the years to come, and will serve to better acquaint the obliged entities with their performance of reporting to GDPML and moreover advance the effectiveness of the utilization of the GDPML's human resources.

Deklarimet e valutës në pikat e kalimit të kufirit

Në zbatim të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe specifikisht, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.15, datë 16.02.2009, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin doganor”, nga DPD është përbushur detyrimi për raportim sistematik pranë DPPP-së të deklarimeve të monedhës cash, nga shtetasit në hyrje dhe dalje të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ky informacion i marrë nga DPD ka rezultuar shumë i vlerësuar, pasi ka shërbyer si indicie për DPPP-në, për të kryer investigime, duke konkluduar edhe në referime tek organet e zbatimit të ligjit.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat për shumatat e deklaruara në pikat e kalimit të kufirit, të raportuara në DPPP, për periudhën 2005-2009, në vlerë sipas valutave si dhe në numër deklarimesh.

	Viti/Year 2005	Viti/Year 2006	Viti/Year 2007	Viti/Year 2008	Viti/Year 2009
Numri i Deklarimeve / Number of declarations	--	33	336	462	551
Shuma në/Amount in EUR	--	1,804,735	3,629,040	5,817,100	7,491,735
Shuma në/Amount in USD	--	1,168,431	3,989,660	5,855,950	5,985,570
Shuma në/Amount in GBP	--	7,000	11,000	-	125,570

Nga një analizë e këtyre të dhënave statistikore evidentojmë se deklaratimet në pikat e kalimit të kufirit kanë një rritje si në numër ashtu edhe në shumatat e deklaruara, krahasuar me gjithë periudhën e mëparshme. Në total, numri i personave që kanë deklaruar cash në dalje gjatë vitit 2009 është 551.

Duke marrë në konsideratë rezultatet e organeve ligjzbatuese dhe institucioneve të tjera në luftën kundër informalitetit në ekonomi dhe impaktin pozitiv të saj në reduktimin gjithnjë e më shumë të përdorimit të parasë fizike, atëherë do të ishte e pritshme, që edhe numri i deklarimeve në kufi dhe vlera totale e tyre të shënonte ulje krahasuar me vitet e mëparshme.

Por në fakt, pikërisht kjo rritje tregon punën e mirë dhe gjithnjë në përmirësim të autoriteteve doganore në këtë drejtim, por njëherësh evi-

Cross border cash declarations

In observance with Law no.9917, May 19, 2008 “On the prevention of money laundering and financing of terrorism ” and more specifically the Instruction no.15, February 16, 2009, of the Minister of Finance “On the prevention of money laundering and fight against the financing of terrorism from the customs authorities”, the reporting obligation that GDC has concerning the orderly reporting of cash declarations by the citizens entering or leaving the territory of the Republic of Albania, has been met.

The information obtained by GDC, has turned out to be quite valuable, and has served as an evidence for GDPML to perform investigation, and upon their conclusion the cases have been referred to law enforcement agencies.

The following table represents the currency amounts of cross border cash declarations, reported to GDPML, during the 2005 – 2009 period.

Based on the analysis of this statistical data it is evident that the cross border declarations have grown both in number as well as the amounts declared compared to all previous periods. During 2009, the total number of persons making a declaration on exit was 551.

Taking into consideration the outcomes of the law enforcement agencies and other institutions towards tackling the informality of the economy and its positive impact for the growing reduction of cash usage, it would be expected that the number of cross border declarations and their total amount would decrease compared to previous years.

As a matter of fact it is specifically this increase that substantiates the performance of the customs authorities to this end, while at the same

denton edhe rezervat e mëdha, pasi deklarimet e bëra janë kryesisht në dalje nga territori ynë dhe kryesisht vetëm nga dogana e Rinasit. Këto rezerva konfirmohen edhe nga Departamenti i Policisë Kufitare në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që ka konstatuar dhe denoncuar në prokurori 8 raste të mosdeklarimit të valutës në kufi.

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka raportuar 132 RTV në vitin 2009. Raportimi ka qenë i rregullt dhe nuk ka patur probleme në regjistrimin e tyre në programet e DPPPP-së. Raportimet janë të pakta në numër krahasuar me informacionin nga noterët mbi kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme. Gjatë vitit 2009 janë bërë disa takime më drejtues të ZQRPP për të diskutuar problematikën në këtë drejtim, gjë që ka filluar të japë rezultate. Mbetet për t'u bërë më shumë nga ZQRPP për dedektimin dhe raportimin e RAD-ve.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË VLERAVE NGA BANKAT SI SUBJEKTE KRYESORE RAPORTUESE

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" më 10 shtator 2008, siç ishte e pritshme, raportimi i bankave u rrit në mënyrë të ndjeshme dhe kjo prirje vazhdoi edhe në vitin 2009. Grafiku i mëposhtëm pasqyron ecurinë e raportimeve në vite që prej fillimit të përpilimit të raporteve vjetore nga ana e DPPPP-së në vitin 2005 e në vazhdim:

Rritja, gati 4 herë më shumë e Raportimeve të Transaksioneve të Vlerave në vitin 2009, krahasuar me vitin paraardhës, ka ardhur kryesisht si rezultat i ndryshimeve ligjore të vitit 2008, ku pragu i raportimit është ulur nga 20 milionë në 6 milionë Lekë. Faktorë të tjerë që kanë ndikuar në rritjen e konsiderueshme të numrit të RTV dhe të larmisë së subjekteve që kanë filluar të


time confirms that there is more to be done since the declarations are made mostly on exiting the territory of Albania mainly in Rinas Customs. This fact is also confirmed by the Department of the Border Police in the General Directorate of State Police that has intercepted and sent to the prosecution 8 cases of cross border non-declaration of currency.

Central Office for the Registration of Immovable Property, has reported 132 VTRs in 2009. The reporting process has taken place regularly and the information has been recorded in GDPML's databases. The number of reports compared to the immovable property sales' contracts filed by the notaries is still insufficient. During 2009, several meetings with CORIP's directors regarding the reporting problems encountered, have taken place and have already started to yield results. More should be done by CORIP with regard to detection and reporting of SARs.

REPORTING OF VALUE TRANSACTION REPORTS FROM BANKS AS THE MAIN OBLIGED ENTITIES

Upon entry into force of the Law no. 9917, May 19 2008 "On the prevention of money laundering and financing of terrorism" in September 10, 2008, the number of bank's reports as it was expected grew significantly and this tendency kept apace in 2009. The chart provides the reporting over the years since the publication of GDPML's annual reports in 2005 and onward.

The almost four fold increase of the Value Transaction's Reports in 2009, compared to previous year, was mainly a result of legal changes of 2008 that were associated with a reporting threshold decrease from 20 million to 6 million Lek. Other factors such as the variety of the obliged entities that did report, the increase of the number of inspections and training of reporting entities, as well as the application



raportojnë, janë rritja e numrit të inspektimeve, rritja e trajnimeve për subjektet raportuese, si dhe aplikimi i masave administrative për mosplotësim të detyrimeve ligjore. Totali i përgjithshëm i raportimeve të transaksioneve të vlerave për vitin 2009 është 985,447, prej të cilave 619,818 (65.85 %) janë transaksione me para në dorë me vlerë mbi 1.5 milionë Lekë dhe 365,629 (34.15 %) janë transaksione më vlerë mbi 6 milionë Lekë.

Një ndër objektivat kryesore të punës së DPPP gjatë vitit 2009 ka qenë mundësimi i raportimit të transaksioneve në mënyrë elektronike, gjë që është realizuar për shumicën e bankave brenda datës 31 dhjetor 2009.


Raportimi i transaksioneve të vlerave nga noterët dhe analizimi i tyre

Duke krahasuar me vitin e kaluar, numri i raportimeve të noterëve është rritur ndjeshëm. Nga 6,059 RTV, të raportuara në vitin 2008, këtë vit numri i raporteve është 11,277 RTV, duke shënuar një rritje prej 86%.

Trajnimi i vazhdueshëm i noterëve, mundësimi i raportimit në rrugë elektronike, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Noterëve, kanë qenë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e numrit të raportimeve nga kjo kategori subjektësh.

Në grafikët në vazhdim paraqiten ecuria e numrit të raportimeve të noterëve, si dhe numri i noterëve që raportojnë për periudhën 2005 – 2009:

Noterët Raportues/Reporting Notaries



of administrative sanctions for non-compliance with legal obligations, had an impact on the considerable increase.

The total number of value transaction's reports in 2009 reached 985,447, out of which 619,818 (65.85 %) are cash transactions over 1.5 million lek and 365,629 (34.15 %) are transactions over 6 million lek.


One of the main GDPML's objectives during 2009, was the implementation of electronic reporting which has been fulfilled for most of the banks on December 31st 2009.

Reports of value transactions from the notaries and their analysis

There has been a significant increase of reporting by the notaries compared to the previous year. In 2008, 6 059 VTRs, were reported while during this year the number reached 11 277 VTRs, marking an 86% increase. The continuous training of the notaries, the enabling of electronic delivery as well as the intensification of cooperation with the National Chamber of Notaries, are some of the main factors that have had an impact with regard to the increase of reporting by this category of entities.

The following charts represent the dynamics of the number of reports filed by the notaries as well as the number of notaries that have reported

Numri i raportimeve RTV të noterëve/The number of VTR reports filed by notaries




Puna e nisur në vitin 2008 me sensibilizimin e noterëve për të raportuar në DPPPP, ka vazhduar me të njëjtin ritëm, duke intensifikuar trajnimet dhe takimet për të sqaruar deri në detaje detyrimet e tyre, si dhe për t'i instruktuar për mënyrat dhe procedurat e raportimit. Grafiku i mësipërm tregon qartë rritjen e numrit të noterëve raportues krahasuar me vitet e mëparshme.

Risi tjetër është edhe shtimi i raportimeve të noterëve nga rrethe e qarqe që nuk kanë raportuar më parë. Më poshtë jepet një paraqitje e dinamikës së shpërndarjes gjeografike për 3 vitet e fundit, ku duket qartë evoluimi dhe rritja e sipërfaqes së mbulimit, duke synuar që në 2010-ën të arrihet raportimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

during 2005 – 2009:

The awareness enhancing efforts started in 2008, with regard to notaries' reporting to GDPML continued apace, by means of enhancing the level of training and meetings that provided clarifications and detailed explanations about their obligations and offering instructions about the reporting procedures. The chart above shows a clear increase with respect to increase of the number of reporting notaries compared to previous years. The increase of the number of notaries' reports from the districts and regions that did not previously report represents a novelty. A geographic distribution for the last 3 years is given hereunder, where the evolution and the growth of outreach is apparent, aiming to achieve the full coverage of the whole territory of the Republic of Albania in 2009.



RRETHET/DISTRICTS	Vt/Yr. 2009
TIRANË	6077
DURRËS	2325
FIER	580
LEZHË	487
SHKODËR	324
SARANDË	314
BERAT	242
PUKË	223
ELBASAN	157
VLORË	152
KAVAJË	144
GJIROKASTËR	54
KORÇË	45
BURREL	40
LAÇ	30
GRAMSH	29
LUSHNJE	27
KUÇOVË	23
SKRAPAR	4
TOTALI/TOTAL	11 277

Tendenca në rritje e vërejtur në vitin 2008 ka vazhduar të thellohet edhe gjatë vitit 2009. Veç trajnimeve, inspektimeve dhe masave të ndërmarrë, rritja ka qenë gjithashtu rrjedhojë dhe e komunikimit të përditshëm me noterët, për të sqaruar informacionin e raportuar dhe për të siguruar ndihmesën në plotësimin e formularëve. Numri i noterëve që kanë raportuar gjatë vitit 2009 ka arritur në 204, kundrejt 120 prej tyre gjatë vitit paraardhës. Pjesën kryesore në totalin e raportimeve vazhdojnë ta zënë: Tirana, Durrësi, Fieri, Lezha dhe Shkodra.

Informacioni i raportuar dhe i ardhur në format letër në DPPPP është informatizuar në shumicën e rasteve të raportuara, falë punës që është bërë nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit. Po kështu, këto raportime kanë rezultuar të dobishme për punën analizuese, pasi mbi bazën e tyre janë inicuar shumë çështje, disa prej të cilave janë referuar në organet e zbatimit të ligjit dhe të tjera janë në proces investigimi. Nga 194 raste të referuara për vitin 2009, në organet e zbatimit të ligjit (Policia e Shtetit, Prokurori, Njësi e Përbashkët e Hetimit), 64 prej tyre kanë si indicie raportimet e transaksioneve të vlerave nga subjektet Noterë. Pavarësisht nga sa më sipër, duhet të evidentojmë se ende rezulton i pa përmbushur detyrimi ligjor, për raportim prej noterëve të rasteve të veprimtarisë së dyshimtë.

Raportimi i transaksioneve të vlerave nga subjektet e tjera të ligjit

Në vitin 2009, përveç bankave dhe noterëve, detyrimi për raportim është përmbushur edhe nga subjekte të tjera të ligjit.

Në mënyrë të përmbledhur grafiku i mëposhtëm paraqet raportet e marra nga subjektet në vitin 2009, të krahasuar me vitin 2007 dhe 2008.

Grafiku tregon që ka një rritje të konsiderueshme, veçanërisht nga institucionet jo-bankare, shoqëritë e ndërtimit, zyrat e këmbimit valutë dhe shoqëritë e tregtimit të makinave, ashtu siç vërehet një ulje të subjektet lojëra fati e kazino. Subjektet Avokatë dhe Agjencitë e Shitblerjes së Pasurive të Paluajtshme kanë filluar të raportojnë për

The growing tendency noted in 2008, was enhanced during 2009. In addition to training, inspections and sanctions imposed, the growth came about as a result of daily communication with the notaries, in order to clarify the information reported by them and provide them with assistance regarding filling out the reports. The number of reporting notaries in 2009, was 204, compared to 120 in the previous year. The bulk of the reports comes from Tirane, Durres, Fier, Lezha and Shkoder.

The information reported and delivered in a hard copy to GDPML, was thereafter largely digitized thanks to the efforts to that end by the Information Technology section.


At the same time these reports have turned out to be quite useful for the analysis activity, and based on them several cases have been initiated and afterwards referred to law enforcement agencies or are undergoing investigation. From a total of 194 referrals to law enforcement agencies in 2009, (State Police, Prosecutor's Office, Joint Investigation Unit) 64 have been initiated based on notaries reports. Nevertheless we should emphasize that the legal obligation, regarding the filing of suspicious reports by notaries, remains unfulfilled.

The reporting of value transactions from other obliged law entities

During 2009, in addition to banks as the main reporting entity, the reporting obligations has been complied with also by other obligors. The graphic below shows the reports filed in 2009 by the obliged entities, in comparison to 2007 and 2008.

There is a significant increase especially from the non bank institutions, construction companies, bureaux de change and car dealers while a decrease can be noticed from the games of chance and casino. The entities listed under Lawyers and Real Estate Agents have started to report for the first time during 2009, 18 and 5 respectively. This constitutes a positive step with respect to compliance with law from

herë të parë në vitin 2009, përkatësisht 18 dhe 5, gjë që përbën një hap pozitiv në drejtim të zbatimit të ligjit nga këto subjekte, si dhe është rezultat i punës sensibilizuese të ndërmarra nga DPPPP.



these entities and comes as a result of the sensitizing activity undertaken by GDPML.

ANALIZIMI FINANCIAR DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2009, një rëndësi e veçantë i është kushtuar analizës financiare të raportimeve të subjekteve të ligjit në DPPPP. Rritja e numrit të personelit të Sektorit të Analizës dhe Teknologjisë së Informacionit ka pasur një ndikim pozitiv në përpunimin, analizimin dhe më tej, shpërndarjen e informacionit tek agjencitë e zbatimit të ligjit. Ndër zhvillimet kryesore në këtë drejtim veçojmë:

- Në DPPPP, me fondet e Delegacionit të BE-së, është realizuar përshtatja dhe implementimi i një programi analitik. Në të gjitha fazat e zbatimit të këtij projekti të rëndësishëm, në bashkëpunim të ngushtë edhe me kompanitë zbatuese, është përfshirë i gjithë personeli i Drejtorisë së Analizës dhe Teknologjisë së Informacionit. Me finalizimin e këtij programi, DPPPP ka plotësuar objektivin e saj për vitin 2009, në marrjen online të informacionit të raportuar nga bankat e nivelit të dytë. Gjatë periudhës së finalizimit të këtij projekti janë marrë masat e nevojshme nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit në zhvillimin e mëtejshëm të funksion-

FINANCIAL ANALYSIS AND INFORMATION TECHNOLOGY

During 2009, GDPML has paid a special attention to the financial analysis of the reports from obliged entities. The personnel increase in the Analysis and Information Technology Section, has had a positive impact vis a vis the processing, analyzing and the dissemination thereafter of the information to law enforcement agencies. Some of the most important developments in this regard are;

- GDPML, has through the generous support of EU Delegation, carried out the customization and implementation of an analytical program. The entire staff of the Analysis and Information Technology Directorate, was involved in all the stages of the implementation of this project in close cooperation with the company in charge of the project. On its completion GDPML has fulfilled its objective for 2009, with reference to receiving online the information from the commercial banks. During the final stage the information technology section has taken all the necessary steps for the further development of the existing case management

alitetit të programit ekzistues të administrimit të çështjeve.

- Në funksion të raportimit elektronik të informacionit, janë marrë masat e duhura, duke hartuar dhe zbatuar praktikisht module të raportimit në format elektronike nga subjektet e ligjit, të cilat bazohen në udhëzimet e Ministrit të Financave. Për implementimin dhe vënien në funksion të këtyre moduleve, me qëllim raportimin elektronik të informacionit, janë realizuar disa trajnime si në DPPPP, ashtu edhe në mjediset e subjekteve. Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka kryer trajnimet për më se 170 Noterë, të cilëve u është ofruar asistencë teknike edhe në zyrat e tyre noteriale. Ky sektor ka kryer trajnime dhe ka ofruar asistencë teknike edhe për subjektet e tjera si, shoqëri ndërtimi, agjenci këmbimi valutor dhe lojëra fati.

- Sektori i Teknologjisë së Informacionit, po në funksion të analizimit të informacionit elektronik, ka kryer procesin e regjistrimit të raportimeve në letër të ardhura nga noterët dhe ka mundësuar raportimin në rrugë elektronike (online) të informacionit nga bankat e nivelit të dytë, duke përbushur kështu një objektivi të vitit 2009.

- Gjatë këtij viti, bashkëpunimi dhe koordinimi me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit është intensifikuar dhe kjo ka sjellë dhe frytet e saj me vendosjen e lidhjes fizike me rrjetin GovNet. Njëkohësisht janë ndjekur të gjithë hapat deri në firmosjen e memorandumeve të bashkëpunimit me DPT dhe DPD, si dhe është realizuar shkëmbimi i informacionit elektronik me këtë të fundit.

Në kuadrin e projektit të binjakëzimit me Policinë Kriminale Federale Gjermane (BKA), janë realizuar disa veprimtari shumë të rëndësishme për stafin e teknologjisë së informacionit, nga të cilët veçojmë:

- Veprimtaria për "Hartimin e një Koncepti për IT", e cila konsistoi në shkëmbimin e përvojave më të mira me ekspertët e Zyrës Federale Kriminale Gjermane, si dhe kalimin e tij në një plan afatmesëm të zhvillimit strategjik të sektorit të Teknologjisë së Informacionit.

- Veprimtaria për "Arkivën Dixhitale", e cila orientohet nga nevoja konkrete e DPPPP-së për një zgjidhje sa më të saktë të procesit të arkivimit dixhital. Nisur nga përvoja e kolegëve të BKA-së, Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka vlerësuar si prioritet të tij për vitin 2010, krijimin e një

program.

- In order to facilitate the electronic reporting of the information the necessary steps have been performed to draft and practically implement the electronic reporting modules by the obliged entities, pursuant to the instructions of the Minister of Finance. A series of training sessions were undertaken both on-site and off-site in order to put into effect those modules. The Information Technology Section has performed this training for more than 170 Notaries, by offering technical assistance in their offices. This training has been offered also to other obliged entities such as construction companies, bureaux de change and games of chance.

- The Information Technology section in support of the information analysis, has carried out the registration of reports delivered by the notaries in hard copy and has provided the means for the electronic reporting (online) of the information by the banks, implementing thus an objective of the year 2009.

- During this year the cooperation with the National Agency for Information Society has been intensified and yielded results through the establishment of a physical connection with the GovNet network. At the same time all the necessary steps have been undertaken leading to the signature of memorandum of cooperation with GDT and GDC. The electronic exchange of information with the latter has already been accomplished.

In the framework of the twinning project with the German Federal Criminal Office (BKA), several quite important activities have taken place for the staff of the information technology, among which we set apart the following:

- The activity for the "Drafting of an IT concept" which consisted in the exchange of best practices with the experts of the German Criminal Federal Office, as well as its implementation through a medium term document for the strategic development of Information Technology.

- The activity for the "Digital Archive", is oriented by the concrete needs of GDPML, for an adequate solution of the digital archiving. Based on the experience of BKA colleagues, the Information Technology Section considers as a priority for 2010, the creation of a concrete plan for the

plani konkret për dixhitalizimin e informacionit arkivor, si dhe mënyrën e aksesimit të tij nga analistët dhe drejtuesit e DPPP-së.

- Në mbështetje të Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", ndryshuar me Ligjin nr. 9541, datë 22.05.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"" dhe të Vendimit nr. 122, datë 15.03.2001, të Këshillit të Ministrave "Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e "certifikatës së sigurisë" personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka vlerësuar si domosdoshmëri procesin e certifikimit të stafit, si dhe certifikimin e rrjetit informatik. Për përbushjen e këtij objekti janë marrë masat për certifikimin e stafit të DPPP-së, si dhe dorëzimin e "Deklaratës së Sigurisë së Rrjetit" në DSIK.

- Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka mirëmbajtur dhe përmirësuar strukturën e faqes zyrtare të internetit të DPPP-së, duke realizuar një transparencë të plotë me subjektet e ligjit, si dhe me publikun. Kjo faqe është rifreskuar vazhdimisht me informacione të reja, si dhe është vënë re një rritje e numrit të vizitorëve (për vitin 2009 numri i vizitorëve ka aritur në 20 694), e cila kalon numrin e dy viteve të mëparshme.

REFERIMI I RASTEVE TË DYSHIMTA NË ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT

Gjatë vitit 2009, janë referuar në organet e zbatimit të ligjit, 194 raste të dyshimta për pastrim parash dhe financim të terrorizmit. Numri i referimeve është pothuajse tre herë më i madh, në krahasim me vitin 2008 dhe 27 herë më shumë se në vitin 2007. Një gjë e tillë është bërë e mundur si rezultat i:

- Punës intensive, duke kryer analiza paraprake mbi kritere profesionale për shumë transaksione komplekse dhe të pazakonta, mbi bazën e të cilave janë iniciuar investigimet;
- Shfrytëzimit efektiv të çdo të dhëne të marrë nga institucione partnere apo homologët;
- Investigimit edhe të personave të lidhur me personat e dyshuar për

digitization of archival information as well its access from the GDPML personnel.

- Pursuant to Law no. 8457, of February 11, 1999 "On the information classified "state secret"", amended with law no. 9541, of May 22, 2006 "On some additions and amendments in the Law no. 8457, February 11 1999 "On the information classified "state secret"" and the Decision no. 122, March 15, 2001, of the Council of Ministers "On the consideration and the issuance of the "security certificate" for persons to be acquainted with the information classified "state secret"", the Information Technology Section, has welcomed the staff certification as well as network certification. To ensure the fulfillment of this goal measures have been taken for the certification of the GDPML's staff as well as the delivery of "Network Security Certificate" by DSCI.

- The Information Technology Section has maintained and improved the GDPML's internet website structure, enabling complete transparency with the obliged entities as well as the public. This page has been continuously brought up to date with the latest information as well as the increase of the numbers of the visitors (during 2009 the number of visitors reached 20 694), which surpasses the number of two previous years.

REFERRALS OF SUSPICIOUS CASES TO LAW ENFORCEMENT AGENCIES

During 2009, 194 money laundering and financing of terrorism cases have been referred to law enforcement agencies. The number of referrals is almost three times higher compared to 2008 and a 27 fold increase compared to 2007. This has been made possible due to:

- Intensive work regarding preliminary analysis based on professional criteria for many complex transactions, which have led to initiation of investigations.
- Better utilization of all the information obtained from partner institutions and international FIUs.
- Investigation of the accomplices of the suspected persons due to the complexity of the transactions or the relevant criminal data, based on

shkak të transaksioneve komplekse, apo për shkak të të dhënave kriminale në ngarkim të tyre, sipas informatave nga institucionet partnere apo homologët;

- Rritjes së shkëmbimit të informacioneve, si dhe numrit të institucioneve, të cilëve u jemi drejtuar për informacion (janë shtuar në vijimësi kërkesat për shoqëritë e transfertave, nga ku kemi marrë informacione tepër të vyera, për DPT, për ZQRPP, njësitë homologe të Inteligjencës Financiare, etj) ;
- Konsultimit me burimet e hapura. Pothuajse për çdo praktike janë bërë kërkime në internet, veçanërisht edhe në faqet zyrtare të gjykatave, prej të cilave kemi marrë indicie dhe konsoliduar dyshimet për çështje shumë të rëndësishme;
- Përdorimit më efektiv të teknologjisë së informacionit;
- Përmirësimin të vazhdueshëm të menaxhimit të burimeve njerëzore.

the information obtained from partner institutions and international FIUs.

- The increase of the exchange of information as well as the number of the institutions to whom we have sent information requests (there has been a continuous increase of the requests for information from money transfer companies whereby valuable information has been obtained, GDT, CORIP, partner Financial Intelligence Units, etc);
- Consultations with open sources. Internet searches have been carried out in almost all cases, especially in the official website of Courts, from which indications have been obtained and suspicions have been consolidated for some important cases;
- A more effective application of information technology;
- Further improvement of the management of human resources.

	Vt./Yr. 2005	Vt./Yr. 2006	Vt./Yr. 2007	Vt./Yr. 2008	Vt./Yr. 2009
Dërguar në Polici për investigim/ Referred to Police for investigation	10	11	5	46	135
Referuar në Prokurori/ Referred to Prosecutor's Office	11	3	2	26	59
TOTALI/ TOTAL	21	14	7	72	194

Tabela e mëposhtë paraqet numrin e referimeve në organet e zbatimit të ligjit për periudhën 2005-2009.

Nga analiza e këtij produkti final prej 194 referimesh në organet e zbatimit të ligjit për vitin 2009, evidentojmë se referimet:


- kanë shpërndarje gjeografike në të gjithë Shqipërinë (edhe çështjet penale të filluara nga Prokuroria dhe të tjera në ndjekje nga policia me indicie informacionin e DPPP-së, kanë subjekte nën hetim apo investigim pothuajse në të gjithë Shqipërinë);
- kanë shpërndarje kohore në të gjithë vitin, çka tregon për punë sistematike të strukturave të DPPP-së;
- kanë larmi mënyrash të përdorura për pastrim parash si: investime në biznese, investime në pasuri të paluajtshme, strukturim të transaksioneve poshtë pragjeve të raportimit, transfertat ekonomikisht të pajustificuara, transfertat drejt parajsave fiskale, mosdeklarim i valutës në pikat doganore, etj;
- kanë indicie nga më të ndryshmet, të cilat jepen të kategorizuara në grafikun e mëposhtëm;

The following table represents the number of referrals to law enforcement agencies during 2005-2009.

Based on the analysis of the 194 referrals in law enforcement agencies during 2009, we conclude that:

- they are geographically spread throughout Albania (the criminal cases initiated from the prosecution and those under investigation from the police based on indications from GDPML, have subjects under investigation almost all over Albania);
- they are spread in time during the whole year which demonstrates the systematic work of the GDPML structures;
- there is a variety of methods used to launder money such as: investments in businesses and real estate, structuring of the transactions below the reporting thresholds, money transfers that are unjustified from the economic point of view, transfers to tax heavens, non declaration of currency in the border crossings, etc;
- the indications are varied and are categorized in the following graph;

Siç duket qartë në grafik, ka një rritje të dukshme të larmisë së burimeve, prej të cilave informacioni i marrë është plotësuar, përpunuar, analizuar dhe referuar në organet e zbatimit të ligjit. Pjesa kryesore e tyre (65%) kanë indicie nga analizimi i raporteve të transaksioneve të vlerave, dhe vetëm për 11% prej tyre, iniciimi i praktikave është bërë i bazuar në raportet e aktivitetit të dyshimtë të institucioneve financiare. Në vitin 2009, DPPPP u ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe të dhënave të siguruar nga burime të hapura, të cilat i janë nënshtruar një analize rigoroze. Për rastet për të cilat ka pasur të dhëna për vepra penale, janë bërë referimet në organet e zbatimit të ligjit.



As it can be seen in the graph, there is a growth of the variety of sources from which the information has been obtained complemented, processed, analyzed and referred to law enforcement agencies. The majority of them (65%) have been initiated based on value transaction reports, while only 11% are based on suspicious activity reports filed from

financial institutions. During 2009 GDPML, has paid special attention to the data obtained from open sources that have undergone a rigorous analysis for cases that contained information for penal offences which were thereafter referred to law enforcement agencies.

Rast i bazuar në raportin e transaksionit të vlerave

Rasti u inicua mbi bazën e një raportimi të një transaksioni, që lidhej me një blerje pasurie të paluajtshme me një shumë të konsiderueshme nga Shtetasi X, pagesa totale e kontratës ishte kryer me para në dorë, dhe që për të cilin burimi i të ardhurave nuk ishte i deklaruar.

Nga verifikimet e kryera nga Njësia e Inteligjencës Financiare, rezultoi që shtetasi dhe bashkëshortja e tij nuk kanë asnjë veprimtari biznesi të regjistruar në emrin e tyre dhe nuk kanë bërë deklarinimin e valutës apo sendeve me vlerë në pikat doganore, si dhe nuk kanë fare llogari bankare.

Bazuar në të dhënat se shtetasi X jetonte në vendin Y të BE-së, i kërkua njësisë homologe të Inteligjencës Financiare të dhëna për këtë shtetas, nga ku rezultoi që ai ishte i përfshirë në veprimtarinë e një grupi të organizuar kriminal, që kishte kryer disa vepra penale në vendin Y.

FIU Shqiptar mori menjëherë masat për bllokimin e pasurive të identifikuar gjatë fazës së hetimit administrativ, si dhe bëri referimin në agjencitë e zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi me këto agjenci vazhdon në lidhje me personat e tjerë të përfshirë në grupin e organizuar kriminal

Case based on a value transaction report

The case was initiated based on a transaction report related to the purchase by citizen X, of an immovable property, for a considerable amount. The total amount of the purchase was paid in cash and there was no declaration of the source of funds

Upon further verifications made by the Financial Intelligence Unit it was concluded that he and his spouse did not engage in any business activity registered on their behalf, did not have any cross border declaration of currency and no bank accounts. Based on the information that citizen X did live in the country Y of the EU, we sent a request to the partner Financial Intelligence Unit to provide additional data regarding this citizen, whereby evidence obtained proving his involvement in an organized criminal group that had committed penal offences in country Y.

The Albanian FIU did immediately undertake the necessary steps for the freezing of the properties identified during the stage of the administrative investigation and the case was referred to the law enforcement agencies. Cooperation with those agencies regarding other individuals involved in the organized criminal group as well as their properties continues. The

dhe pasuritë e tyre. Inicimi i praktikës bazuar në disa tregues si vlera e lartë e pagesës me para në dorë dhe fakte të tjera që tregonin burimin e paligjshëm të të ardhurave, si dhe bashkëpunimi më njësinë homologe të Inteligjencës Financiare përbëjnë pikat e forta të këtij hetimi financiar. Procesi i pastrimit të parave ndodhet në fazën e vendosjes dhe shtresëzimit të fondeve dhe pasurive të përftuara në rrugë kriminale.

case was initiated based on some indicators such as the considerable cash payment, facts that put into question the legal source of funds, as well as the cooperation with the partner Financial Intelligence Unit and those are some of the strong points of this financial investigation. The laundering process was in the placement and layering stage of criminally obtained proceeds and property.

RASTET E REFERUARA NË PROKURORI

Në grafikun e mëposhtëm jepen të dhënat mbi rastet e referuara nga DPPPP në Prokurori, për periudhën 2005 - 2009.

Gjithashtu, konstatojmë që mbi 8% e rasteve të detektuara dhe referuara e zënë rastet, ku vepra penale të origjinës janë ato të korrupsionit aktiv. Veçojmë këtë fakt, për shkak se korrupsioni është padyshim fenomeni më i rrezikshëm për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe pikërisht për këtë arsye legjislatori u ka bërë një rregullim të posaçëm marrëdhënieve të subjekteve raportuese me klientët PEP.

Siç prezantohet, gjatë vitit 2009, janë dërguar në organin e Prokurorisë për investigime dhe ndjekje të mëtejshme 59


raste, gjë që përbën një rritje të dyfishtë krahasuar me vitin 2008, dhe e pakrahasueshme me vitet e mëparshme.

DPPPP ka kërkuar feedback nga Prokuroritë e Rretheve, si dhe nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore, për rastet e referuara, me qëllim vlerësimin e efikasitetit të hetimeve financiare të kryera, si dhe për të pasur të dhëna statistikore. Në këtë kuadër, Njësia e Përbashkët Hetimore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit, na ka informuar që për 30 raste të referuara nga DPPPP, për 18 prej tyre ka pasur të dhëna dhe indicie për veprën penale të parashikuar nga neni 287 "Pastrimi i produkteve të veprës penale", i Kodit Penal.

CASES REFERRED TO THE PROSECUTION

The following graph includes the cases referred to Prosecution by GDPML during the period 2005 - 2009.

More than 8% of the cases detected and referred consist of cases those that had active corruption as a predicate offence.



We highlight this fact since corruption is undoubtedly the most dangerous phenomenon for the economic development of the country, and due to this reason, the relations of the obliged entities with PEPs have been specifically regulated by the legislators.

As it is presented, during 2009, 59 cases have been sent to the Prosecution for further investi-

gation and follow up that marks a two fold increase compared to 2008 and incomparable with previous years. GDPML has requested feedback from the regional prosecutions as well as Joint Investigation Units, for the cases referred, in order to evaluate the effectiveness of the financial investigations as well as compile statistical data. In this framework the Joint Investigation Unit attached to Tirana's Judicial District during the second half of the year, has confirmed that out of 30 cases referred by GDPML, 18 of them contain indications regarding the criminal offence stipulated by article 287 "Laundering of the proceeds of crime", of the Criminal Code.

MASAT E PËRKOHSHME

Në zbatim të nenit 22, të Ligjit nr. 9917, dt. 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka të drejtë, kur ka fakte apo rrethana konkrete që lënë për të dyshuar se një transaksion apo veprim financiar ka lidhje me pastrim parash apo financim të terrorizmit, të bëjë bllokimin e tij për 72 orë, dhe nëse ka elementë të veprës penale, të njoftojë Prokurorinë.

Kjo mundësi ka qenë e përcaktuar dhe në Ligjin nr. 8610, dt. 17.05.2000, "Për parandalimin e pastrimit të parave" i ndryshuar, por vetëm në vitin 2008 e në vazhdim është bërë efektive, duke arritur kulmin në vitin 2009, gjatë të cilit DPPP me 23 urdhëra bllokimi, ka bllokuar mbi 4 milionë Euro llogari, depozita dhe asete. Bllokimi është kryer në përputhje me afatet e parashikuara në ligj dhe referimet janë bërë menjëherë pranë organeve ligjzbatuese për kompetencë dhe veprim.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna të detajuara në lidhje me urdhërat dhe shumatat e bllokuara.

Risi tjetër për vitin 2009 është se këto bllokime të përkohshme, të kryera nga DPPP, janë shoqëruar me sekuestrimin e më se 80% të tyre më vendim të magjistratëve (prokurorë dhe gjykatës), gjë që dëshmon bashkëpunimin në rritje dhe efikasitetin e këtyre masave parandaluese.

	Viti/Year 2007	Viti/Year 2008	Viti/Year 2009
Urdhëra Bllokimi/Freezing Orders	0	5	23
Llogari bankare të bllokuara/Frozen bank accounts	0	45	47
Bllokuar/Frozen EUR	0	504,934	3,736,275
Bllokuar/Frozen USD	0	486,046	20,000
Bllokuar/Frozen LEKE	0	952,032	31,737,850
Bllokuar truall/Frozen land lots (m2)	0	0	1,060 m2
Sekuestruar nga Prokuroria e Gjykata/ Seized by the Prosecution and Courts	0	0	2,946,275 EUR 31,662,565 LEKE 1,060 m2

TEMPORARY MEASURES

Pursuant to article 22, of the Law no.9917, of May 19, 2008 "On the prevention of money laundering and financing of terrorism", the General Directorate for the Prevention of Money Laundering, is empowered when there are facts or circumstantial evidence that lead to suspect that one transaction or financial operation is related to money laundering or financing of terrorism, to freeze it for 72 hours, and if there are elements of predicate offence to notify the Prosecution.

This possibility was defined in the Law no.8610, May 17th 2000, "On the prevention of money laundering" amended, but only in 2008 and onward did become effective, culminating in 2009, when GDPML did issue 23 freezing orders, blocking deposits and assets amounting to more than 4 million Euros. The freezing was performed in accordance with the timeframe stipulated in the law and the referrals were made immediately to law enforcement agencies for follow up and proceedings. The following table presents detailed data related to freezing orders and the amounts blocked.

The temporary freezing carried out by GDPML in 2009 and, and the seizure of more than 80% of the amount following the decision of the magistrates (prosecutors and judges), is a testimony of the increasing of the cooperation and the effectiveness of the preventive measures.

RASTE TË DËRGUARA NË POLICINË E SHTETIT PËR INVESTIGIM TË MËTEJSHËM

Objektivi kryesor i DPPPP-së është parandalimi, detektimi dhe referimi i rasteve të dyshimta për pastrim parash dhe financim të terrorizmit, tek organet e zbatimit të ligjit.

Përveç rasteve të referuara në Prokurori, DPPPP ka rritur në mënyrë të konsiderueshme numrin e çështjeve të referuara në Policinë e Shtetit, duke tentuar rritjen e shkëmbimit të informacionit për raste të dyshimta për pastrim parash dhe për burime jo legale të të ardhurave.


Në grafikun e mëposhtëm jepen statistikat mbi rastet e referuara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën 2005 – 2009.

CASES REFERRED TO ALBANIAN STATE POLICE FOR FURTHER INVESTIGATION

GDPML's main objective is the prevention, detection and the referral of money laundering/financing of terrorism suspicious cases to law enforcement agencies.

Besides the cases referred to the Prosecution, GDPML has considerably increased the number of the cases referred to State Police, striving to increase the exchange of the information with regard to money laundering suspicious cases and illegal sources of income.

The following chart provides statistical data regarding the number of cases referred to General Directorate of State Police, during 2005 – 2009.



Siç duket dhe nga grafiku, ka një rritje të konsiderueshme të rasteve të referuara në DPPSH. Në vitin 2009, janë referuar 135 raste, ose gati tre herë më shumë krahasuar me vitin paraardhës. Vlen të theksojmë faktin, që sipas infomacioneve të marra nga DPPSH, nga 135 çështje të referuara nga DPPPP, 34 prej tyre janë referuar në Prokurori dhe për 31 çështje ka filluar procedimi penal.

As it can be seen in the graph, there is a considerable increase of the cases referred to ASP. In 2009, 135 cases have been referred or more than three times compared to the previous year. It is worth highlighting the fact that based on the confirmation by ASP, from 135 cases referred by GDPML, 34 out of them have been referred to the Prosecution and for 31 of them penal proceedings have been initiated.

Rast i bazuar në raportin e transaksionit të dyshimtë

Rasti u inicua mbi bazën e një raportimi të një transaksioni të dyshimtë nga një subjekt i ligjit. Dy shtetas kanë depozituar një shumë të konsiderueshme në një nga bankat që operojnë në Shqipëri, duke cituar punën në emigracion si burim të të ardhurave.

Nga informacioni i marrë nga organet tatimore, rezultoi që shtetasit nuk janë pronarë të asnjë veprimtarie biznesi në vend. Nga kërkimet e mëtejshme të bëra, rezultoi se një person me lidhje familjare me shtetasit e mësipërm ishte arrestuar në një vend fqinj për trafikim të lëndëve narkotike.

Në hetimin financiar në vijim, Njësia e Inteligjencës Financiare mblodhi të dhëna shtesë për transaksionet financiare të kryera në llogaritë bankare të shtetasve, si dhe arriti të marrë të dhëna edhe për pasuri të paluajtshme të regjistruara në emrin e tyre.

Bazuar në të dhënat konkrete për përfshirje në kryerjen e veprave penale, të cilat kanë gjeneruar të ardhura të jashtëligjshme, të cilat më pas janë përdorur për të mbështetur veprimtari biznesi, Njësia e Inteligjencës Financiare ndërmori hapa të menjëhershëm për të bllokuar fondet e depozituara në llogaritë bankare, si dhe bëri referimin e çështjes në organet e zbatimit të ligjit.

Inicimi i praktikës u bë si pasojë e disa treguesve të pazakontë dhe të pajustificuar nga pikëpamja ekonomike, si vlera të larta të shumave të depozituara në llogaritë bankare dhe mungesa e të dhënave konkrete për përfshirjen e shtetasve në veprimtari biznesi të ligjshme. Në sajë të përpjekjeve intensive të Njesisë së Inteligjencës Financiare u bë e mundur që të merreshin të dhëna shtesë nga burime të tjera, të cilat pranonin së të ardhurat ishin gjeneruar nëpërmjet përfshirjes në veprimtari të jashtëligjshme të lidhjeve familjare të tyre.

Case based on a suspicious transaction report

The case was initiated based on a suspicious activity report by an obliged entity. Two individuals had deposited a considerable amount of money in one of the commercial banks operating in Albania, quoting their work as immigrants as the source of the funds.

Based on the information obtained by the tax authorities it was concluded that those individuals were not engaged in any business activity in the country. Upon further searches made by the GDPML personnel, a relative of one of the above individuals was arrested in a neighboring country for involvement in dealing with narcotics.

During the ensuing financial investigation the Financial Intelligence Unit obtained additional information regarding the transactions carried out by the individuals in their bank accounts and managed to get supplementary evidence for the immovable properties registered on their behalf.

Based on evidence obtained, regarding the involvement in the commission of criminal offences that did generate illegal proceeds that have been later on to fund a business activity the Financial Intelligence Unit did take immediate steps to freeze the funds deposited in the bank accounts and referred the case to the law enforcement agencies.

The case was initiated as a result of several unusual and economically unjustified indicators, such as the considerable value of amounts deposited in the bank accounts and the lack of evidence of their involvement in legal business activities. As a result of the intensive efforts of the Financial Intelligence Unit additional information was obtained from other sources that proved that the income were generated through involvement in illegal activities of their relatives.

KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI
NË NIVEL KOMBËTAR E NDËRKOMBËTAR



COORDINATION AND COOPERATION
AT THE NATIONAL AND INTERNATIONAL LEVEL

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Në funksion të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në vijimësi DPPP i ka kushtuar rëndësi të posaçme bashkëpunimit në tërësi me institucionet shtetërore, duke patur në konsideratë objektin e detyrës dhe specifikat që ka secili institucion. Për këtë bashkëpunim ndërinstytucional evidentojmë se duhet të vijë në rritje te vazhdueshme në funksion të përmbushjes së:

- Dispozitave ligjore për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit, të të dhënave për veprimtarinë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Kërkesave të Qeverisë për luftë me tolerancë zero kundër këtyre fenomeneve të rrezikshme;
- Detyrave specifike të dhëna nga KBLKPP.

Në këtë periudhë ka patur një sërë arritjesh në intensifikimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, ndër të cilat mund të përmendim:

- Nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit me ILDKP-në në Mars 2009;
- Nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet DPPP-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet DPPP-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i cili ka hyrë në fuqi në Korrik 2009;
- Rritjen e shpejtësisë së përgjigjeve nga ana e DPD-së, DPT-së dhe ZQR-PP-së, ndaj kërkesave të DPPP-së;
- Rritjen e numrit të raportimeve të transaksioneve të vlerave nga shumë zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Marrjen e masave për hartimin e akteve të domosdoshme në funksion të parandalimit të pastrimit të parave, siç është edhe rregullorja përkatëse, si dhe të organizimit të seminareve të ndryshme për njohjen dhe sensibilizimin e punonjësve të ZVRPP me rreziqet në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Informacionin sistematik për deklarimet e valutës në pikat kufitare, nga DPD;
- Informimin nga DPD në disa raste për të dhëna mbi dyshimet për pastrim parash, të siguruara prej homologëve të tyre ndërkombëtarë;
- Krijimin e Sektorit të Parandalimit të Pastrimit të Parave, brenda Drejto-

INTER-INSTITUCIONAL COOPERATION

In the framework of prevention of money laundering and financing of terrorism, GDPML has paid special attention continuously to the cooperation in general with state institutions, taking into account the objectives and specific tasks that each of these institutions has. We bring to light the fact that this inter institutional cooperation should be enhanced in order to fulfill:

- Legal provisions for the collection, analysis and dissemination to law enforcement agencies of information related to potential involvement in money laundering or financing of terrorism activities;
- Government's request for zero tolerance against these dangerous phenomena;
- Specific tasks established by CCFAML.

During this time the following achievements can be enumerated concerning the strengthening of inter-institutional cooperation:

- The signature in March 2009 of the Memorandum of Understanding with HIDAA;
- The signature of the Memorandum of Understanding among GDPML and the General Directorate of Taxation;
- The signature of the Memorandum of Understanding among the GDPML and General Directorate of Customs, that became effective in July 2009;
- Swift responses from GDC, GDT and CORIP, for the requests made by GDPML;
- The increase of the number of value transactions from many local offices for the registration of immovable property;
- Measures taken to draft the necessary acts with reference to the functions of prevention of money laundering, such as the relevant regulation, the organization of workshop for the employees of CORIP aiming at sensitizing them about the risks in the domain of money laundering and financing of terrorism;
- Systematic information from GDC with regards to cross border declarations of currency;
- GDC's reports regarding money laundering related data obtained by their international partners;

risë Antitrafik, në DPD, gjë që ka ndikuar në mënyrë direkte në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional;

- Rritjen e bashkëpunimit me AAPSK.

Megjithëkëtë, evidentojmë se ende rezulton i papërbushur në nivelin e kërkuar detyrimi ligjor për raportim të rasteve të aktivitetit të dyshimtë, kryesisht nga DPT, ZQRPP, i sanksionuar në Ligjin nr. 9917 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, gjë që është e mundur të arrihet, për shkak të vetë shtrirjes së strukturave të tyre në të gjithë territorin e vendit.

Grupi Teknik Ndërinstitucional i KBLKPP-së, në të cilin bëjnë pjesë përfaqësues nga DPPSH, DPT, DPD, DPPPP, PP, SHISH, BSH, ILDKP, ZQRPP, etj., ka zhvilluar takime intensive, në të cilat janë trajtuar çështjet e poshtëshënuara:

- Hartimi i dokumentit strategjik kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”;
- Rritja e raportimeve nga ZQRPP, Shoqëritë e Ndërtimit dhe Dhoma e Noterëve;
- Thëllimi i bashkëpunimit me Prokurorinë dhe Policinë, që në fazat e para të hetimeve për rastet e dyshimta;
- Informacione të vazhdueshme mbi ecurinë e projektit të binjakëzimit me BKA;
- Rritja e shpejtësisë dhe saktësisë në shkëmbimin e informacionit, si dhe mundësimi i aksesimit nga DPPPP në bazat e të dhënave të organeve shtetërore dhe në regjistrat publikë;

Bashkëpunimi me Njësinë e Përbashkët Hetimore pranë Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë këtij viti ka vazhduar të jetë rezultativ. Kjo është e evidente, nisur nga rritja e numrit të referimeve të bëra pranë kësaj njësie nga DPPPP, që është shumë i përafërt me numrin e çështjeve penale në proces që po heton Prokuroria. Bashkërendimi i punës ndërmjet NjPH-së dhe DPPPP-së duket qartë dhe nga sekuestrimi i mbi 80% të aseteve dhe llogarive të bllokuara nga DPPPP.

Krahas raportimeve të mirëfillta në Prokurori dhe në Policinë e Shtetit, DPPPP ka vënë në dispozicion të Prokurorisë kapacitetet e saj profesionale për çështjet e iniciuara nga kjo e fundit. Në vitin 2009, është kërkuar informacion financiar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe prokuroritë e rretheve të ndryshme, për 56 raste, nga 45 të tilla në vitin 2008 dhe 28 në 2007.

- Creation of an Anti Money Laundering Section within GDC’s Anti-Traffic Directorate, that has directly contributed towards the strengthening of the inter-institutional cooperation;

- Strengthening of the cooperation with AASCA;

Nevertheless, we point out the fact that the legal requirement to file suspicious activity reports mainly from GDT, CORIP that are stipulated in the Law no.9917 “On the prevention of money laundering and terrorism financing ” remains unfulfilled. This could be achieved, given the geographic presence of its structures across the country.

CCFAML ‘s Inter-Institutional Technical Group which includes representatives from ASP, GDT, GDC, GDPML, PO, SIS, BoA, HIDAA, CORIP, etc., has conducted intensive meetings where the following topics have been considered:

- The formulation of a National Strategic Document “On the investigation of financial crime ”;
- The growth of the number of reports from CORIP, Construction Companies and the Chamber of Notaries;
- Strengthening of the cooperation with the Prosecution and Police, from the inception phase of the investigation of suspicious cases;
- Continuous sharing of information regarding the performance of the twinning project with the German Federal Criminal Office (BKA);
- The speedier and more accurate exchange of information as well as enabling GDPML’s access to databases of state institutions and public registers;

Cooperation with the Joint Investigation Unit in Tirana’s Judicial District Prosecution, has continued to yield results. This is evident based on the increase of the number of referrals to this unit by GDPML that is approximate to the number of criminal cases that prosecution is investigating. Cooperation of the activity among the JIU and GDPML is also highlighted also by the seizure of more than 80% of the assets frozen by GDPML.

In addition to referrals to Prosecution and the State Police, GDPML has made available its professional capabilities to Prosecution with regard to cases initiated by the latter. In 2009, information has been requested by the Prosecution of Serious Crimes Court and regional prosecutions for 56 cases, compared to 45 in 2008 and 28 in 2007.

Këto të dhëna dëshmojnë nivelin në rritje të përfshirjes së DPPP-së, jo vetëm në luftën për parandalimin e pastrimit të parave dhe krimit financiar, por edhe në atë të luftës kundër bazës ekonomike të krimit të organizuar në vend. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka në objekt të punës së saj, ndër të tjera dhe ndjekjen penale të organizatave kriminale. Nga bashkëpunimi me këtë Prokurori, kemi kryer verifikime të vlefshme për fonde dhe asete të këtyre organizatave, mbi bazë të hetimeve të filluara prej tyre dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar për ekzekutimin e letër-porosive. Nga numri i investigimeve financiare të kryera mbi bazën e kërkesave të Prokurorisë, kryesisht asaj të Krimeve të Rënda, grumbullimi dhe analizimi i informacionit financiar për persona ndaj të cilëve është në vazhdim procedimi penal, konstatohet se ka një tendencë në rritje. Gjithsesi, nga analizimi i një materiali mjaft voluminoz të grumbulluar mbi bazën e kërkesave të Prokurorisë, kemi konstatuar se efektiviteti i kësaj veprimtarie është i ulët, për shkak se nga ana e prokurorive, kërkesa të tilla bëhen në një stad të avancuar të hetimeve e për rrjedhojë, personat e dyshuar dhe lidhjet e tyre kanë pasur kohë për të fshehur dhe zhdukur gjurmët e parave dhe aseteve. Për të siguruar një rritje të mëtejshme të efektivitetit të bashkëpunimit, kemi theksuar domosdoshmërinë e fillimit të bashkërendimit dhe hetimit financiar që në fazat e para të procedimit penal.

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit ka njohur gjithashtu rritje në vitin 2009. Ky bashkëpunim, veçanërisht me Drejtorinë e Luftës Kundër Krimit Ekonomik, vërehet në analizimin e rasteve të veçanta, por edhe në takimet e përbashkëta në kuadër të Grupit Teknik Ndërinstitucional, në kuadër të hartimit të strategjisë për hetimin e krimit financiar, etj. Hapa përpara janë bërë dhe përsa i përket aksesimit në bazën e të dhënave policore, nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave mbi hyrje-daljet e personave në territorin e Republikës së Shqipërisë. Caktimi në DPPSH i një personi kontakti për këtë qëllim ka lehtësuar mbledhjen e informacionit për hetimet financiare që kryhen nga DPPP. Po ashtu, është hartuar një projekt-marrëveshje bashkëpunimi, që synon të zgjerojë dhe përmirësojë më tej nivelin e aksesit të DPPP-së në të dhënat e Policisë së Shtetit, e cila është parashikuar të nënshkruhet brenda tremujorit të parë të vitit 2010.

Shkëmbimi i informacionit me SHISH ka pasur rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2009 krahasuar me të gjithë periudhën që prej krijimit të DPPP-së. Informacion i detajuar është shkëmbyer për 81 çështje, për hetime financiare të rasteve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

These data are a testimony to the ever increasing involvement of GDPML, not only in the fight against prevention of money laundering, but also in combating the economic bases of the organized crime in the country. The objective of the Prosecution for Serious Crimes is among others to prosecute criminal organizations. In cooperation with this institution we have carried out verifications of funds and assets of these organizations based on investigations initiated by them as well as in the framework of international cooperation concerning the execution of rogatory letters. Based on the number of financial investigations conducted upon the request of the Prosecution, mainly of that of the Serious Crimes, collection and analysis of the financial information about persons who are subject of ongoing penal proceedings, it can be stated that the trend is pointing upward. Nonetheless based on the analysis of the voluminous documentation gathered upon the request of the Prosecution, we have concluded that the effectiveness of this activity is quite low, due to the fact that these requests are made at an advanced stage of the investigations and therefore the suspected persons and their collaborators, have had time to conceal the traces of funds and assets. In order to ensure further effectiveness of the cooperation, we have emphasized the imperative of initiating the cooperation for financial investigations, since the inception stages of the penal proceedings.

The cooperation with the State Police did also advance in 2009. This cooperation especially with the Directorate for the Fight Against Economic Crimes, is noticed in the analysis of particular cases, but also in mutual meetings in the framework of the Inter-Institutional Technical Group, the formulation of the strategy for the investigation of the financial crime, etc. Advancements have been made towards access of the police databases, by means of the exchange of information regarding entry and exit of persons in the territory of the Republic of Albania. The appointment to this end in the ASP of a contact person has facilitated the collection of information, for the investigation of financial crimes carried out by GDPML. A draft agreement aiming at expanding and improvement of the level of access that GDPML has in the databases of the State Police is expected to be signed within the first quarter of 2010.

The exchange of information with SIS in 2009 has grown considerably compared to all the period since the inception of GDPML. The detailed information has been exchanged for 81 cases, regarding the financial

Vendosja e personave të kontaktit për DPPP dhe SHISH ka ndikuar në shkëmbimin më të shpejtë dhe efikas të të dhënave dhe informacioneve. DPPP i ka kushtuar vëmendje krejt të veçantë çdo të dhënë për dyshime të mundshme për financim të terrorizmit. Kjo është pasqyruar në monitorimin e vazhdueshëm të listave të zeza të përditësuara të Këshillit të Sigurimit të OKB- së, në sistemin bankar dhe subjektet e tjera të ligjit. Nga raportet e veprimtarisë së dyshimtë të ardhura nga bankat e nivelit të dytë, është bashkëpunuar për dy raste me DPPSH dhe SHISH, për investime të mëtejshme.

Koordinimi me ILDKP ka ardhur vazhdimisht në rritje në takime të përbashkëta, seminare dhe shkëmbime informacioni. Ky bashkëpunim është shtrirë edhe në hartimin e listës së PEP, një detyrim ligjor për ILDKP, i përcaktuar në nenin 28, të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Listën e PEP, të përpiluar dhe përditësuar periodikisht nga ILDKP, DPPP ua ka vënë në dispozicion subjekteve të ligjit për të ushtruar vigjilencë të zgjeruar në marrëdhëniet e biznesit me klientët e përfshirë në këtë kategori.

Shkëmbimi i informacionit me ILDKP ka vazhduar pandërpreje gjatë vitit 2009. Gjatë vitit kemi patur bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë institucion, si në kërkesat që u kemi drejtuar, ashtu edhe në përgjigjet e ardhura.

Për vetë rëndësinë e madhe dhe ndikimin e drejtpërdrejtë që ka bashkëpunimi ndërinstitucional, përveç akteve nënligjore të miratuara në zbatim të Ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", bazuar në propozimet e bëra edhe nga DPPP, janë miratuar akte nënligjore nga Qeveria Shqiptare, që normojnë, rregullojnë dhe e bëjnë të detyrueshëm këtë bashkëpunim, si:

- VKM nr. 400, datë 22.04.2009, "Për përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor", sipas të cilit Drejtoria e Hetimit Tatimor bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, me anë të shkëmbimit të informacionit, në funksion të zbulimit të krimeve në fushën e tatimeve dhe pastrimit të parave.
- VKM nr. 1077, datë 27.10.2009, "Për miratimin e Dokumentit Strategjik Kombëtar "Për hetimin e krimit financiar"", në të cilin përfshihen objektiva dhe veprimtari konkrete për të gjitha institucionet e përfshira në luftën kundër krimit financiar në përgjithësi dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në veçanti.

investigation of money laundering and financing of terrorism cases. Appointment of contact points in GDPML and SIS has had an impact on the faster and efficient exchange of information GDPML has paid special attention to any information containing financing of terrorism potential data. This has been reflected in the ongoing monitoring of UNO's Security Council updated black list, in the banking system and other obliged entities of the law. Based on the suspicious activity reports obtained by the banks, GDPML has cooperated with SIS for two cases that warranted further investigations.

Coordination with HIDAA, has increased continuously through mutual meetings, workshops and exchange of information. This cooperation is extended to the drafting of the PEP's list, pursuant to HIDAAS's legal requirement stipulated in article 28, of the Law no. 9917, May 19th 2008 "On the prevention of money laundering and financing of terrorism". The PEP's list is periodically updated by HIDAA and is made available to obliged entities by GDPML, in order to carry out enhanced due diligence in their business relations with clients included in this category. The exchange of information with HIDAA during 2009 has been continuous. During the year the cooperation has been ongoing with regard to the request sent as well as the responses received.

Given the particular importance and the direct impact that the inter-institutional cooperation has, in addition to the bylaws approved pursuant to the law "On the prevention of money laundering and financing of terrorism", based on proposals made among others from GDPML, the Albanian Government has approved the following bylaws that provide norms, regulate and make the cooperation obligatory:

- CMD no.400, April 22nd 2009, "On the definition of tasks and functions of the Directorate for Tax Investigation" according to which the Directorate for Tax Investigation cooperates with the General Directorate for the Prevention of Money Laundering by means of exchange of information, concerning the exposure of tax and money laundering offences.
- CMD no.1077, October 27th 2009 "On the approval of the National Strategic Document "For the investigation of financial crime"" that includes concrete objectives and activities for all the institutions involved in the fight against financial crime in general and particularly money laundering as well as financing of terrorism.

- VKM nr. 1103, datë 14.11.2009, “Për miratimin e planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit”, sipas të cilit përcaktohen afatet konkrete për përmbushjen e detyrimit për aksesim të të dhënave të institucioneve shtetërore, sipas nenit 22, të Ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.
- VKM nr. 1276, datë 23.12.2009, që autorizon DPPPP të bëjë verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore të shtetasve.

BASHKËPUNIMI ME PARTNERË DHE INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE

DPPPP, që vepron dhe si Njësi e Inteligjencës Financiare Shqiptare (NIF) - që prej 23 korrikut 2003, anëtare me të drejta të plota në Grupin EGMONT, i cili është një forum ndërkombëtar për të realizuar bashkëpunimin për shkëmbimin e informacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, bashkëpunon me një sërë njësisish homologe në mbarë botën. Po kështu, që prej krijimit të Komitetit MONEYVAL, DPPPP ka qenë e përfaqësuar në Delegacionin Shqiptar në seancat plenare të këtij komiteti, pothuajse vazhdimisht me ekspertët e saj financiarë.

Marrëveshjet e bashkëpunimit

Në përmbushje të misionit të saj dhe në funksion të rritjes së bashkëpunimit me njësitë homologe të Inteligjencës Financiare në nivel ndërkombëtar, numri i Memorandumeve të Mirëkuptimit (MoU) që ka nënshkruar DPPPP që prej krijimit të saj është 33. Këto memorandume e lehtësojnë kooperimin reciprok përsa i përket shkëmbimit të informacionit me strukturat homologe ndërkombëtare, që janë anëtare të Grupit EGMONT. Gjatë vitit 2009 janë nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi me njësinë homologe të Federatës Ruse - ROSFINMONITORING dhe njësinë homologe të Kanadasë – FINTRAC, si dhe janë në proces e sipër procedurat e nënshkrimit me Njësinë e Inteligjencës Financiare të Argjentinës. Tabela e mëposhtme përmban MoU-të e nënshkruara sipas një rendi kronologjik, që prej krijimit të DPPPP.

- CMD no.1103, November 14th 2009 “On the approval of cross cutting strategy and action plan for the fight against organized crime, trafficking and terrorism”, that defines clear timeframe with regard to the fulfillment of the obligation to provide access to state institutions, in accordance with article 22, of the law “On the prevention of money laundering and financing of terrorism”.
- CMD no. 1276, December 23rd 2009, that entitles GDPML to verify electronically, the penal background of the citizens.

COOPERATION WITH INTERNATIONAL PARTNERS AND INSTITUTIONS

GDPML acts as the Albanian Financial Intelligence Unit (FIU) and is since July 23rd 2003, full member of the EGMONT Group, that is an international forum aiming to accomplish the cooperation and the exchange of information, with regard to the prevention of money laundering and financing of terrorism, and as such it does cooperate with a large number of Financial Intelligence Units worldwide. At the same time GDPML has been represented almost continuously, through its financial experts in the Albanian Delegation, in the plenary sessions of the MONEYVAL Committee.

Memorandums of Understanding

In order to accomplish its mission and increase the cooperation with the international partner Financial Intelligence Units, GDPML has signed since its inception onward 33 Memorandums of Understanding (MoU). Those memorandums do facilitate the mutual cooperation with regard to the exchange of information with the international partner institutions that are members of the EGMONT Group. During 2009, two Memorandums of Understanding were signed with the Financial Intelligence Unit of the Russian Federation - ROSFINMONITORING as well as the Financial Intelligence Unit of Canada - FINTRAC and the process of signature with the Argentinean Financial Intelligence Unit is underway. The following table contains a chronological list of MoU signed from the establishment of GDPML.

	Juridiksioni / Jurisdiction	Njif / FIU	Data e nënshkrimit / Date of signing
1.	Sllloveni/Slovenia	OMLP	30.01.2003
2.	Bullgari/Bulgaria	FIA	09.06.2003
3.	Maqedoni/Macedonia	MLPD	26.01.2004
4.	Mali i Zi/Montenegro	APML	06.03.2004
5.	Kroaci/Croatia	AML	07.06.2004
6.	Salvador/El Salvador	UIF	14.06.2004
7.	Republika Çeke/Check Republic	FAU-CR	14.06.2004
8.	Liban/Lebanon	SIC	14.06.2004
9.	Estoni/Estonia	RPAB	15.06.2004
10.	Barbados/Barbados	AMLA	15.06.2004
11.	Serbi/Serbia	APML	28.06.2004
12.	Portugali/Portugal	UIF	23.09.2004
13.	Qipro/Cyprus	MOKAS	27.09.2004
14.	Finlandë/Finland	RAP	25.10.2004
15.	Taiwan/Taiwan	MLPC	05.11.2004
16.	St.Vincent&Grenadines	FIU-SVG	07.12.2004
17.	Kore/Korea	KoFIU	31.12.2004
18.	Slllovakia/Slovakia	SJFP UBPOK	15.02.2005
19.	Guatemalë/Guatemala	IVE	05.04.2005
20.	Ukrainë/Ukraine	SDFM	06.04.2005
21.	Rumani/Romania	ONPCSB	06.04.2005
22.	Venezuelë/Venezuela	UNIF	12.04.2005
23.	B-Hercegovinë/B.& Herzegovina	FID	18.11.2005
24.	Kosovë/Kosovo	FIC-UNMIK / FIC EULEX	21.02.2006 / 04.02.2009
25.	SHBA/USA	FINCEN	06.03.2006
26.	Moldavi/Moldavia	SPCSB	13.12.2006
27.	Australi/Australia	AUSTRAC	01.03.2007
28.	Poloni/Poland	GIIF	15.11.2007
29.	Aruba/Aruba	MOT	27.05.2008
30.	Paraguaj/Paraguay	SEPRELAD	13.06.2008
31.	Turqi/Turkey	MASAK	21.07.2008
32.	Federata Ruse/Russian Federation	ROSFINMONITORING	03.12.2009
33.	Kanada/Canada	FINTRAC	21.12.2009

BASHKËPUNIMI ME NJËSITË HOMOLOGE TË RAJONIT

Në kuadrin e bashkëpunimit rajonal, DPPP ka vazhduar të ruajë dhe të zhvillojë marrëdhënie të mira me njësitë homologe të Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Serbisë dhe Sllovenisë. Shkëmbimi i informacionit ka qenë i vazhdueshëm dhe efikas. Në muajin Nëntor 2009, u zhvillua në Tiranë një veprimtari trajnimi nga UNODC, ku merrnin pjesë ekspertë të njësive të Inteligjencës Financiare të Ballkanit Perëndimor (Bosnjë dhe Hercegovinë, Greqi, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi dhe Shqipëri), të cilët në punën e tyre janë të angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me analizat financiare të rasteve që kanë të bëjnë me pastrimin e produkteve të veprave penale dhe financim të terrorizmit. Ky seminar, përveç marrjes së përvojës nga ekspertët australianë dhe britanikë, shërbeu edhe për njohjen më nga afër dhe vendosjen e urave të kontaktit dhe besimit reciprok ndërmjet analistëve financiarë të vendeve të rajonit.

Marrëdhënia e bashkëpunimit me Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës (FIC) është konsoliduar më tej me rinëshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes dy institucioneve në Shkurt 2009, për arsye të kalimit të FIC nga juridiksioni i UNMIK në atë të EULEX. Mbi këtë bazë, niveli i shkëmbimit të informacionit ka njohur gjithashtu rritje. DPPP ka pritur dy delegacione të FIC të nivelit menaxherial dhe operacional, me të cilët ka diskutuar për rritjen e bashkëpunimit, sidomos në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekspertizës financiare.

Risi për vitin 2009 është vendosja e urave të komunikimit me Njësinë e Inteligjencës Financiare të Greqisë. Marrëdhëniet me këtë njësi kanë njohur rritje të ndjeshme sasiore dhe cilësore, gjë që ka ndikuar jo vetëm në marrjen e shpejtë të informacionit për çështjet financiare që investigohen nga DPPP, por dhe në të dhëna konkrete, të cilat janë konkluduar më tej me referime në organet e zbatimit të ligjit.

COOPERATION WITH REGIONAL PARTNER INSTITUTIONS

In the framework of regional cooperation, GDPML has continued to maintain and develop good relations with partner units in Bosnia-Herzegovina, Croatia, Kosovo, Montenegro, Macedonia, Serbia and Slovenia. The exchange of information has been continuous and effective. In November 2009, a training activity took place in Tirana under the guidance of UNODC. The workshop was attended by experts from Financial Intelligence Units of Western Balkans (Bosnia-Herzegovina, Croatia, Greece, Kosovo, Montenegro, Macedonia, Serbia and Albania) that are directly involved in the financial analysis of the cases related to laundering of proceeds of crime and financing of terrorism. In addition to the experience acquired by the Australian and British experts this workshop did play a role towards the closer acquaintance and the establishment of mutual trust among the financial analysts of the regional countries.

The cooperation with the Kosovo's Financial Intelligence Unit (FIC) was further consolidated with the re-signature of a Memorandum of Cooperation among the two institutions in February 2009, due to the fact that FIC was transferred from the jurisdiction of UNMIK to that of EULEX. Based on this the level of information exchange has also increased. Two managerial and operational FIC Delegations have visited GDPML, to discuss the increase of cooperation with regard to Information of Technology and financial expertise.

The establishment of communication channels with the Financial Intelligence Unit of Greece in 2009 has been a novelty. The relations with this unit has undergone a significant qualitative and quantitative change, that has impacted not only the quicker reception of information regarding financial cases that are investigated by GDPML, but also in providing real evidence that have been concluded with referrals to law enforcement agencies.

BASHKËPUNIMI ME GRUPIN EGMONT DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT NËPËRMJET RRJETIT ESW

Njësitë e Inteligjencës Financiare, anëtare të Grupit EGMONT, mbledhen rregullisht për të gjetur mënyra të reja bashkëpunimi për sa i përket shkëmbimit të informacioneve, për trajnimin dhe shkëmbimin e përvojave reciproke, ndërsa një herë në vit organizohet mbledhja plenare e EGMONT. Gjatë vitit 2009, DPPPP nuk është përfaqësuar në mbledhjen plenare të EGMONT për arsye të mungesës së vizave dhe sqarimeve nga FIU organizator. Gjithsesi, DPPPP nëpërmjet ESW ka marrë pjesë aktive në dhënien e ideve për pyetsorët e ndryshëm në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Shtrirja globale, zgjerimi e konsolidimi i mëtejshëm i grupit EGMONT, niveli i eksperiencës së vëndeve anëtare, angazhimi i kapaciteteve profesionale të fushave të ndryshme, vizibiliteti në rrafshin ndërkombëtar, ofrojnë mundësi gjithnjë në rritje për Njlf Shqipëtar i cili do të vazhdojë gjatë vitit 2010, të jetë pjesëmarrës aktiv në mbledhjet plenare dhe ato të grupeve të punës.

Shkëmbimi i informacionit nëpërmjet ESW, ka vazhduar të mbajë të njëjtin trend rritje. Gjatë vitit 2009, njësitë homologe të Inteligjencës Financiare kanë dërguar 36 kërkesa për informacion te DPPPP. Në disa raste informacioni i mbledhur nga subjektet raportuese në vend, për llogari të njërive të Inteligjencës Financiare, ka rezultuar me interes edhe për DPPPP, dhe disa prej çështjeve janë referuar në organet shqiptare të zbatimit të ligjit, pas marrjes së miratimit nga Njlf përkatëse. DPPPP ka kërkuar informacion nga njësitë homologe të Inteligjencës Financiare për 114 raste. Në mënyrë tabelare, shkëmbimi i informacionit për 5 vitet e fundit paraqitet si vijon:

COOPERATION WITH EGMONT GROUP AND THE EXCHANGE OF INFORMATION THROUGH ESW NETWORK

The Financial Intelligence Units of the EGMONT Group meet regularly in order to find new methods of cooperation with regard to information exchange, training and mutual transfer of experiences, and the plenary sessions of EGMONT Group take place on yearly bases. During 2009, GDPML was not represented in the EGMONT plenary sessions, due to the lack of visa issuance and clarifications of the organizing FIU. Nevertheless GDPML has participated actively in providing ideas related to the various questionnaires in the framework of fight against money laundering and financing of terrorism.

The global span, further expansion and consolidation of EGMONT group, the level of experience of member states, engagement of professional capabilities of various domains, visibility at the international level, do offer ever increasing possibilities for the Albanian FIU that will continue to be an active participant in the plenary sessions and the working groups.

The exchange of the information through ESW has continued the upward trend. During 2009, partner Financial Intelligence Units have sent requests for information to GDPML for 36 cases. In several instances the information obtained in response to the requests of partner Financial Intelligence Units, did contain sufficient information that after the consent of the relevant FIU, warranted the referral to law enforcement agencies in Albania. GDPML has requested information from partner Financial Intelligence Units for 114 cases. The following table provides information regarding the exchange of the information for the last 5 years:

	Kërkesa nga NjIF Ndërkomb. Requests from Int. FIU	Kërkesa nga DPPPP Requests from GDPML	Përgjigje NjIF Ndërkomb. Response from Int. FIU	Përgjigje nga DPPPP Response from GDPML
2005	16	14	1	1
2006	33	32	26	23
2007	24	20	22	18
2008	26	44	108	37
2009	36	114	124	50

Statistikat e dhëna në tabelën e mësipërme tregojnë qartë rritjen e shkëmbimit të informacionit nëpërmjet rrjetit ESW, krahasuar me vitet paraardhëse, 2007 dhe 2008. Numri i kërkesave që DPPPP u ka dërguar NjIF homologe në vitin 2009, është mëse dyfishuar në krahasim me vitin e mëparshëm. Në raste të caktuara janë marrë përgjigje nga më shumë se një NjIF homologe jashtë vendit. Gjithashtu DPPPP për çdo kërkesë të marrë ka ofruar më shumë se një përgjigje në ato raste kur ka patur të dhëna shtesë. Në vitin 2009, numri i kërkesave të bëra nga njësitë e Inteligjencës Financiare është rritur me 38% dhe numri i përgjigjeve që DPPPP ka dhënë është rritur me 35%.

Ky shkëmbim informacioni ka qënë shumë rezultativ në konsolidimin e dyshimeve për çështje të hapura nga ana jonë, në marrjen e të dhënave shtesë prej tyre, si dhe për verifikimin rast pas rasti të transfertave, kur janë shfaqur në transaksione të pazakonta.

KOMITETI MONEYVAL

Gjatë vitit 2009, DPPPP ka vijuar të jetë e angazhuar në veprimtarinë e Delegacionit Shqiptar në Komitetin MONEYVAL. Pjesëmarrja e përfaqësuesit të DPPPP-së si Kryetar i Delegacionit Shqiptar në mbledhjet e këtij komiteti, ka qënë e vazhdueshme në të tri seancat plenare të zhvilluara në vitin 2009.

Në këto seanca, janë paraqitur në mënyrë të detajuar dhe të vazhdueshme ndryshimet në fushën ligjore, financiare dhe atë të zbatimit të ligjit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe fi-

The statistical data provided in the table above clearly shows the upward trend for the exchange of information through ESW network, compared to previous years 2007, 2008. The number of requests sent by GDPML, to partner FIUs in 2009, has more than doubled compared to the previous year. In specific cases there has been more than one response by partner FIUs outside of the country. GDPML has also offered additional information and therefore more than one response for some requests. In 2009 the number of requests made by Financial Intelligence Units has increased by 38% and the number of responses provided by GDPML increased by 35%.

This exchange of information has turned out to be quite successful in consolidating the suspicions for the opened cases, obtaining additional data as well as verification on case by case bases when unusual transactions have been identified.

MONEYVAL COMMITTEE

During 2009, GDPML will continue to remain engaged in the activities of the Albanian Delegation in the MONEYVAL Committee. The participation of the representative of GDPML as the Head of Delegation in the meetings of this committee has been ongoing in the all three plenary sessions carried out during 2009.

A detailed account was provided in those plenary sessions of legal, financial and law enforcement changes related to prevention of money laundering and financing of terrorism in Albania, coupled

nancimit të terrorizmit në Shqipëri, shoqëruar më të dhëna konkrete që dëshmonin intensifikimin e punës në këtë drejtim.

Në seancën e 30-të plenare të zhvilluar në Shtator 2009, Delegacioni Shqiptar kishte rolin e Komisionit ad-hoc të rishikimit të raportit të progresit të Armenisë sipas fushave përkatëse ligjore, financiare dhe atë të zbatimit të ligjit. Krahas përfshirjes në mënyrë aktive në punimet e seancave plenare, anëtarët e delegacionit kanë qenë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në veprimtari të tjera që organizon dhe koordinon komiteti, si dhe ka dhënë kontributin e tij të vazhdueshëm në hartimin e projekteve të tipologjive të ndërmarrja në fushën e sigurimeve e të lojërave të fatit, si dhe studimin e tendencave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që ndeshen në këto fusha.

DPPPP- ja do të vazhdojë të angazhohet në mënyrë aktive në mbledhjet plenare, në hartimin e raporteve dhe studimeve tipologjike që ndërmarrin anëtarët, si dhe në veprimtaritë e tjera, ku komiteti është i pëfshirë. DPPPP do të punojë pareshtur për rritjen e nivelit të bashkëpunimit shumëpalësh dhe dypalësh në kuadrin e veprimtarive që incion dhe monitoron Komiteti MONEYVAL.

with the relevant data. This is a testimony of the intensification of the activity in this domain.

During the 30th Plenary Session of September 2009, the Albanian Delegation had the role of the Ad-Hoc Review Commission concerning Armenia's progress report in the legal, financial and law enforcement fields. Alongside the active engagement in the plenary sessions, the members of the delegation have continuously participated in other activities organized and coordinated by the committee and has contributed towards the typologies' projects undertaken in the domain of insurance, internet gambling and the studies of money laundering and financing of terrorism trends encountered in those areas.

GDPML will continue to remain actively engaged in the plenary sessions, case studies and typology reports undertaken by the members, as well as other activities carried out by the committee. GDPML will continue to work tirelessly to enhance the multilateral and bilateral level of cooperation in the framework of the activities initiated and monitored by the MONEYVAL Committee.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2010

Arritjet e vitit 2009 janë një bazë e qëndrueshme për vazhdimin e zbatimit konkret të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të përcaktuar nga KBLKPP.

Forcimi i mëtejshmëm i kapaciteteve profesionale të DPPP-së dhe institucioneve të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave do të vazhdojë të jetë një nga drejtimet prioritare të punës për vitin 2010. Po ashtu, thellimi i procesit të dixhitalizimit të informacionit në DPPP, nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe rritja e bashkëpunimit operacional ndërmjet institucioneve informative dhe atyre të zbatimit të ligjit.

Në vitin 2010, DPPP do të përfshihet në zbatimin e Dokumentit Strategjik Kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në Tetor 2009.

Studimi i prirjeve dhe tipologjive të pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit, rritja e mëtejshme sasiore dhe cilësore e trajnimeve të subjekteve të ligjit si një mjet efektiv për zbatimin korrekt të kërkesave të ligjit, intensifikimi i përfshirjes së autoriteteve të mbikqyrjes në procesin e monitorimit të zbatimit të ligjit nga subjektet, përmirësimi i mëtejshëm i kategorizimit të subjekteve mbi bazën e rrezikut për pastrim parash dhe financim të terrorizmit, përbëjnë drejtimet kryesore të punës së DPPP-së në raport me subjektet e ligjit dhe autoritetet që i mbikqyrin ato.

Hartimi i një plani afatmesëm të zhvillimit strategjik të sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Sinkronizimi i procesit të mbledhjes, ruajtjes dhe krijimit të treguesve Statistikorë në DPPP.

Në funksion të përpunimit të shpejtë dhe me cilësi të të dhënave dhe verifikimeve të duhura, realizimi teknik i aksesit në bazën e të dhënave të çdo institucioni shtetëror dhe regjistri publik, përbën një

OBJECTIVES FOR 2010

The achievements of 2009 are a solid base for the continuation of the concrete implementation of the general state policy in the domain of prevention of money laundering and terrorism financing, defined by the CCFAML.

Further consolidation of the GDPML professional capabilities and Institutions involved in the fight against money laundering will continue to be in 2010, one of the main priorities of the activity. The enhancement of the information digitization in GDPML will be continuously supported by the Information Technology Section and the operational cooperation among informative institutions and law enforcement agencies.

In 2010, GDPML will be involved in the implementation of the National Strategic Document “For the investigation of the financial crime” approved with the Decision of the Council of Ministers in October of 2009.

The main priorities of the activities of GDPML and the oversight authorities will be focused in the formulation of case studies of the money laundering and financing of terrorism trends and typologies, further increase of training both quantitative and qualitative for the obliged entities as an effective tool for the adequate for the implementation of the legal requirements, further improvement of the risk based approach categorization of the obliged entities vis a vis the exposure to money laundering and financing of terrorism

The formulation of a medium term plan for the strategic development of the Information Technology section and the coordination of the process of the collection, storage and compilation of the Statistical indicators within GDPML.

The implementation of technical access the databases of every state institution and public registers in cooperation with their proprietary

objektiv të rëndësishëm të DPPP-së, bashkë me institucionet pronare të këtyre të dhënave, detyrim ligjor ky i kërkuar për t'u realizuar edhe nga Kryeministri në takimin e fundit të KBLKPP- së.

Krijimi i një plani konkret për dixhitalizimin e informacionit arkivor, si dhe mënyrës së aksesimit të tij nga specialistët dhe drejtuesit.

Përpilimi i një Programi Afatmesëm për zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit në DPPP, ku do të pasqyrohen në mënyrë të detajuar objektivat për zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe veprimtaritë konkrete që do të ndërmerren në këtë drejtim. Për hartimin e këtij dokumenti do të merren në konsideratë propozimet e bëra gjatë projektit të binjakëzimit "Lufta kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar" nga kolegët gjermanë të Zyrës Kriminale Federale, si dhe forumeve të tjera ndërkombëtare apo më gjerë.

Intensifikimi i bashkëpunimit me autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit në vend në funksion të arritjes së synimit parësor të Ligjit, që është parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili ka filluar të sjellë natyrshëm rezultate të prekshme. DPPP do të vazhdojë të marrë pjesë aktivisht në fazën e përgatitjes dhe zbatimit të projekteve që mbështeten nga Delegacioni European, si dhe institucionet e tjera ndërkombëtare në vend.

owners, will be an important objective of GDPML concerning the speedier processing and validation of the data, fulfilling this way the legal obligation demanded by the Prime Minister during the last meeting of the CCFAML.

Creation of a concrete plan for the digitization of the archival information as well as the methods of its accession by the specialists and administrators.

A medium term program for the technological development of the Information Technology in GDPML will contain detailed objectives for the development of the information technology and the concrete activities to be undertaken to this end. The formulation of this document will take into account the proposals made during the twinning project "Tackling money laundering and financial crime" by the German Colleagues of the Federal Criminal Office, international fora and beyond.

Strengthening of the cooperation with other competent law enforcement authorities in the country in order to achieve the main legal function of prevention of money laundering and financing of terrorism that will bring about tangible outcomes. GDPML will continue to be actively involved in the preparation and implementation stage of the projects supported by the European Union Delegation as well as other international institutions in the country.